



Komisioni i Komuniteteve të Evropës,
për dhe në emër të
Qeverisë së Shqipërisë,

Ref.: EuropeAid/124909/C/SER/AL

Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri

Komponenti A: Legjislacioni



4 Dhjetor 2009

Ky raport është përgatitur nga ekipi i projektit që punon për Grontmij I Carl Bro nën iniciativën e financuar nga projekti CARDS 2006 i Bashkimit Evropian. Gjetjet, konkluzionet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument janë vetëm të Grontmij I Carl Bro dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të konsiderohen se reflektojnë opinionet dhe politikat e Komisionit Evropian.

Komisioni i Komuniteteve të Evropës, për dhe në emër të
Qeverisë së Shqipërisë,

Ref.: EuropeAid/124909/C/SER/AL

Zbatimi i Planit Kombëtar për
Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor në
Shqipëri

Udhëzime për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Falenderime:

Ekipi i projektit dëshiron t'u shprehë mirënjohjen e tij të gjithë ekspertëve e personave burim nga të gjitha institucionet dhe të gjithë palëve të interesit të përfshirë në grumbullimin e të dhënave dhe informacionit si edhe të gjithë personave dhe trupave që kanë mbështetur zhvillimin e këtij Raporti. Falenderime të veçanta i bëhen Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave si edhe stafit ekspert të saj.

Përmbajtja e Lëndës

1	HYRJE	4
2	DIREKTIVA PËR VNM	5
3	LIGJI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS	6
3.1	Kur kërkohet VNM ?	6
3.1.1	Raporti paraprak i VNM	7
3.1.2	Listat e kontrollit për raportin paraprak të VNM	8
3.2	Raporti i thelluar i VNM	9
3.2.1	Përmbajtja e Raportit të Thelluar të VNM	10
3.2.2	Raporti i thelluar VNM Scoping	10
3.2.3	Lista e kontrollit për Raportin e thelluar të VNM	11
3.2.4	Ndikimet jo të drejtëpërdrejta dhe të akumuluar dhe bashkëveprimet e ndikimeve	11
3.2.5	Lista e kontrollit e çështjeve që duhen konsideruar për përfshirje në një Raport të thelluar të VNM	15
3.3	Rishikimi i Raportit të thelluar të VNM	15
	ANEKSI 1 LISTAT E KONTROLLIT PËR RAPORTIN PARAPRAK TË VNM	17
1.	Një listë kontrolli për raportin paraprak të VNM	17
	Aneks 1.B Lista e kontrollit e Kritereve për Vlerësimin e Rëndësisë së Efekteve në Mjedis	21
	ANEKSI 2 LISTAT E KONTROLLIT PËR RAPORTIN E THELLUAR TË VNM	22
	Aneksi 2.A.1 Karakteristikat e Projektit	22
	Aneksi 2.A.2 Karakteristikat e Mjedisit të Projektit	30
	Aneks 2.B Lista e Kontrollit të Kritereve për Vlerësimin e Rëndësisë së Efekteve në Mjedis	33
	Aneksi 2.C Lista e Kontrollit të Alternativave Potenciale dhe Masave Lehtësuese	34
	ANEKSI 3. LISTA E KONTROLLIT E ÇËSHTJEVE QË DUHEN SHQYRTUAR PËR T'U PËRFSHIRË NË NJË RAPORT TË THELLUAR VNM	36

**ANEKSI 4. RISHIKIM I LISTËS SË KONTROLLIT PËR RAPORTIN E THELLUAR
TË VNM**

40

Lista e Shkurtimeve

AMP Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve

VNM Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

1 Hyrje

1. Ky dokument hedh dritë mbi projekt ligjin “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” (këtëj e tutje referuar si Ligji për VNM). Ky Ligj transpozon Direktivën 85/337/KEE për vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin (Direktiva VNM) e amenduar nga Direktiva 97/11/KE dhe nga Direktiva 2003/35/KE.
2. Ky udhërrëfyes është synuar kryesisht për përdorim nga stafi i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, stafi i Agjencive Rajonale të Mjedisit, zhvilluesit dhe konsulentët që përgatisin Raportet e VNM. Gjithashtu mund të shfaqë interes për autoritetet e tjera që kanë rol në VNM dhe procesin e lejes së zhvillimit si edhe për anëtarët e publikut që dëshirojnë të kuptojnë më mirë procedurat e VNM në Republikën e Shqipërisë.
3. Ky Ligj i ri për VNM anullon Ligjin Nr. 8990 datë 23.01.2003 “Për Vlerësimin e Mjedisit” dhe Ligjin Nr. 9700 datë 26.03.2007 “Për Mbrojtjen e Mjedisit nga Ndikimet Ndërkufitare”.
4. Ky dokument është planifikuar si një udhërrëfyes. Ai duhet të lexohet së bashku me Ligjin. Vetëm Gjykatat mund të bëjnë ndonjë deklaratë autoritare të ligjit.

2 Direktiva për VNM

5. Qëllimi kryesor i kësaj Direktive është të sigurojë që autoriteti që jep aprovimin për zhvillimin e një projekti të veçantë e merr vendimin në bazë të njohurive për çdo efekt të mundshëm madhor mbi mjedisin. Direktiva përcakton procedurën që duhet ndjekur për disa lloj projektesh përpara se të jepet leja e zhvillimit. Kjo procedurë e vlerësimit në mjedis është një mekanizëm për të mbledhur bashkë në një vlerësim sistematik efektet e mundshme të rëndësishme që mund të shkaktojë në mjedis një projekt i propozuar. Kjo gjë do të ndihmonte për t'u siguruar që rëndësia e efekteve të parashikuara dhe mundësia e pakësimit të këtyre efekteve, kuptohen plotësisht nga publiku dhe nga autoriteti përpara se të marrë vendimin mbi lejen e zhvillimit.
6. Të gjitha projektet e renditura në Aneksin I të Direktivës hamendësohen të kenë efekte të mundshme të rëndësishme në mjedis dhe prandaj duhet të jenë gjithmonë subjekt i VNM.
7. Projektet e tipit të renditura në Aneksin II të kësaj Direktive duhet të jenë subjekt i VNM në të gjitha rastet kur ka të ngjarë të ketë efekte të rëndësishme në mjedis. Për këtë arsye kërkohet vendimi nëse duhet ose jo një VNM (raporti paraprak) për të gjitha projektet e renditura në Aneksin II. Ky vendim duhet t'i vihet në dispozicion publikut.
8. Në rastet kur kërkohet një VNM, ka tre hapa kryesore që ndiqen për procedurën e VNM:
 - a. Zhvilluesi duhet të hartojë informacion të detajuar rreth projektit të propozuar si edhe rreth efekteve kryesore të mundshme në mjedis. Për të ndihmuar zhvilluesin në këtë detyrë, çdo autoritet publik që zotëron informacionin përkatës duhet ta verë atë në dispozicion të zhvilluesit. Gjithashtu, zhvilluesi mund të kërkojë mendimin e autoritetit kompetent në lidhje me llojin e informacionit që duhet përfshirë (mendimi për raportin e thelluar të VNM);
 - b. Ky raport i VNM duhet venë në dispozicion të publikut. Autoriteteve që kanë përgjegjësi specifike për mjedisin dhe publikut duhet t'u jepet mundësia të japin komentet dhe mendimet e tyre rreth projektit të propozuar si edhe rreth Raportit të VNM;
 - c. Raporti i VNM, së bashku me çdo informacion tjetër që ka lidhje si edhe komentet dhe mendimet nga autoritetet mjedisore dhe publiku duhet të merren në konsideratë nga autoriteti kompetent në procesin e tyre të vendimarrjes kur vendosin ta japin apo jo lejen e zhvillimit. Publiku duhet të informohet për këtë vendim dhe arsye pse është marrë ky vendim.

3 Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

9. Ligji zbatohet si për projektet publike ashtu edhe për ato private.
10. Për zhvilluesit proçesi i VNM mund të ndihmojë të identifikohen efektet e mundshme të një projekti të veçantë në fazën e hershme. Kjo gjë sjell përmirësime në planifikimin dhe hartimin e zhvillimit; në vendimarrjen nga të dyja palët; dhe në konsultimin dhe përgjigjet për zhvillimin e propozuar, veçanërisht nëse kombinohet me konsultime të hershme me autoritetet përkatëse dhe trupa të tjerë të interesuar gjatë fazave përgatitore. Përveç kësaj, zhvilluesit mund ta gjejnë VNM një mjet për të marrë në konsideratë përjasje alternative për një zhvillim. Kjo gjë mund të rezultojë në një propozim përfundimtar që është më i pranueshëm nga ana mjedisore. Prezantimi i informacionit mbi mjedisin në mënyrë më sistematike mund të thjeshtojë gjithashtu detyrën e autoritetit vendor të planifikimit për vlerësimin e aplikimit të planifikimit dhe hartimin e kushteve të përshtatshme të planifikimit, duke mundësuar arritjen e vendimeve më të shpejta.
11. Termi 'vlerësimi i ndikimit në mjedis' (VNM) përshkruan një proçedurë që duhet ndjekur për disa lloj projektesh përpara se t'u jepet 'leja e zhvillimit'. Proçedura është një mjet për të skicuar bashkë, në një mënyrë sistematike, një vlerësim për efektet e mundshme të rëndësishme të projektit. Kjo gjë ndihmon për t'u siguruar që rëndësia e efekteve të parashikuara dhe shkalla e pakësimit të tyre, kuptohen plotësisht nga publiku dhe autoritetet përkatëse përpara se të marrin vendim.
12. Vlerësimi i ndikimit në mjedis mundëson që t'u jepet pesha e duhur faktorëve mjedisorë dhe atyre ekonomikë ose social, kur merret në shqyrtim projekti i propozuar. Ai ndihmon në promovimin e një modeli të qëndrueshëm të zhvillimit fizik dhe tokës dhe përdorimit të pronës në qytete, qyteza dhe fshat. Nëse kryhet siç duhet, sjell përfitime për të gjithë ata që përfshihen në proçesin e planifikimit.

3.1 Kur kërkohet VNM ?

13. Ligji zbatohet për dy lista të veçanta projektesh:
 - a. Projektet e Aneksit I, për të cilat kërkohet në çdo rast një VNM e thelluar;
 - b. Projektet e Aneksit II, për të cilat kërkohet një VNM e thelluar vetëm në rastin kur një projekt i caktuar vlerësohet se ka të ngjarë të shkaktojë efekte të rëndësishme në mjedis.
14. Ndryshimet ose shtesat e projekteve të renditura në Aneksin I ose Aneksin II të cilat mund të kenë efekte të rëndësishme negative në mjedis, janë gjithashtu brenda objektit të Ligjit.
15. Çdo projekt, pavarësisht nëse është apo jo në Aneksin I ose II, i cili mund të ketë një ndikim në një Zonë Veçanërisht të Mbrojtur do të kërkojë automatikisht një VNM Paraprake.

16. Në rastet e dyshimta, këshillohet që zhvilluesi të konsultohet me Ministrinë ose AMP nëse projekti i tij bie nën objektin e Ligjit.
17. Për projektet e Aneksit II, nëse kërkohet apo jo një VNM e thelluar varet nga probabiliteti i “efekteve të rëndësishme në mjedis”. Kjo do të varet, pjesërisht, nga lloji i projektit dhe madhësia e projektit. Sa më e ndjeshme të jetë vendodhja nga ana mjedisore, aq më shumë mundësi ka që projekti të ketë efekte të rëndësishme dhe që të kërkohet një VNM e thelluar.

3.1.1 Raporti paraprak i VNM

18. Për t'i ardhur në ndihmë Ministrisë të marrë vendim nëse një projekt i renditur në Aneksin II do të kërkojë apo jo një VNM të thelluar, zhvilluesi duhet së pari të përgatisë një Raport Paraprak për VNM. Ky proces quhet raport paraprak i VNM.
19. Raporti Paraprak i VNM së pari dërgohet tek AMP që merr një vendim paraprak dhe më pas dërgohet tek Ministri që merr vendimin përfundimtar. Në marrjen e vendimit të saj paraprak, AMP konsultohet me një numër autoritetesh të tjera përkatëse për të marrë komentet e tyre.
20. Në marrjen e këtij vendimi për raportin paraprak të VNM, pyetja bazë që duhet bërë është “a do të kishte mundësi që ky projekt i veçantë të ketë efekte të rëndësishme në mjedis?”. Nëse përgjigja është “po” atëherë do të kërkohet një Raport i Thelluar i VNM. Paragrafët e mëposhtëm mund të ndihmojnë në marrjen e këtij vendimi dhe t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.
21. Si pikënisje, autoritetet duhet të marrin në konsideratë kriteret e përcaktuara në Aneksin III të Ligjit. Aneksi III përcakton kriteret e përzgjedhjes që duhet të merren në konsideratë kur vendoset nëse një projekt ka të ngjarë të ketë efekte të rëndësishme në mjedis. Jo të gjitha kriteret do të kenë lidhje në të çdo rast.
22. Megjithatë, Aneksi III identifikon tre kritere të gjera të cilat duhet të konsiderohen:
 - a. Karakteristikat e projektit (psh. Madhësia e tij, përdorimi i burimeve natyrore, sasi të ndotjes dhe mbetjet e prodhuara)
 - b. Ndjeshmëria mjedisore e vendodhjes së propozuar
 - c. Karakteristikat e ndikimit potencial (psh. shkalla dhe kohëzgjatja)
23. Megjithëse vendimi për raportin paraprak të VNM do të merret në bazë të rasteve të veçanta, ka më shumë të ngjarë që një VNM e thelluar të kërkohet për:
 - a. Projektet e mëdha të cilat kanë rëndësi më tepër se sa lokale
 - b. Projektet që janë propozuar për vende që janë veçanërisht të ndjeshme ose të rrezikuara
 - c. Projektet që janë tepër komplekse dhe që bartin efekte potencialisht të rrezikshme për mjedisin.
24. Këto kritere për raportin paraprak të VNM tani diskutohen me më shumë hollësi.
25. Në disa raste shkalla e projektit të propozuar, në vetvete, mund të jetë e mjaftueshme që të ketë efekte me një gamë të gjerë në mjedis, në mënyrë të tillë që do ta justifikonte një VNM të thelluar.
26. Marrëdhënia midis një projekti të propozuar dhe vendodhjes së tij ka një rëndësi thelbësore. Sa më e ndjeshme të jetë vendodhja nga ana mjedisore, aq më shumë mundësi ka që të ketë efekte të rëndësishme dhe që të kërkohet një VNM e thelluar.
27. Konsideratë e veçantë i duhet kushtuar të gjitha zonave të mbrojtura, veçanërisht atyre që janë zona ndërkombëtare konservimi. Këtu përfshihen zonat që janë klasifikuar ose

që ka të ngjarë të klasifikohen si Zona Veçanërisht të Mbrojtura nën Direktivën për Zogjtë e Egër (79/404/KEE), Zonat e Veçanta të Konservimit nën Direktivën për Habitatet (92/43/KEE), ose terrenet Ramsar (ligatinat me rëndësi ndërkombëtare). Konsideratë e veçantë i duhet kushtuar gjithashtu të gjitha zonave të mbrojtura kulturore apo arkeologjike. Për këtë arsye AMP duhet të konsultohet me këto autoritete përkatëse.

28. Kur merret në konsideratë ndjeshmëria e një vendodhje të veçantë, duhet t'i kushtohet rëndësi edhe faktit nëse ndonjë nga standartet mjedisore kombëtare apo ndërkombëtare të aprovuara janë përjasur apo thyer ndërkohë. Këtu do të përfshiheshin të gjitha standartet e cilësisë së ajrit osë standartet e cilësisë së ujit.
29. Për shembull, nëse projekti i propozuar është në ose pranë një plazhi, efekti i projektit të propozuar për standartet e ujërave që përdoren për të bërë banjë do të kishte shumë lidhje.
30. Disa projekte të propozuara mund të kenë të ngjarë të kenë efekte të rëndësishme në mjedis për shkak të natyrës së ndikimit të tyre. Konsideratë i duhet kushtuar projekteve që mund të kenë ndikime komplekse, afatgjata ose të pakthyeshme dhe në rastet ku analiza e ekspertit dhe e detajuar e këtyre ndikimeve do të ishte e dëshirueshme dhe do të kishte lidhje me çështjen nëse do të lejohej apo jo projekti. Zhvillimi industrial që përfshin shkarkime të cilat janë potencialisht të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe natyrën mund të bjerë nën këtë kategori.
31. Mund të ketë projekte të propozuara për toka tepër të ndotura. Zhvillimi i vetë projektit mund të çojë në largimin e ndotësve më të rrezikshëm nga terreni se sa ç'mund të ndodhte në rastin kur zhvillimi nuk do të bëhej fare. Përsëri, kjo duhet marrë në konsideratë.
32. Kur marrin vendim nëse duhet një VNM e thelluar apo jo, autoritetet duhet të sigurojnë që ata nuk kanë të bëjnë me atë projekt të veçantë të propozuar në izolim: ata duhet të sigurojnë që zhvilluesi (ose zhvilluesit) nuk e kanë ndarë projektin në projekte më të vogla në mënyrë që të përqipen dhe të shmangin nevojën për një VNM të thelluar. Nëse projekti specifik shikohet në mënyrë më korrekte si një pjesë integrale e një projekti më të madh, atëherë vlerësimi duhet bërë në bazë të projektit më të madh.
33. Kjo nuk do të thotë që çdo projekt që është pjesë e një projekti më të madh duhet konsideruar në këtë kontekst: do të jetë e nevojshme të përcaktohet nëse secili nga projektet e propozuara mund të procedonte vetë dhe nëse qëllimet e Ligjit janë shmangur nga dorëzimi i një sërë aplikimesh (ndarja në feta e sallamit).
34. Projektet që konsistojnë në ndryshim apo shtyrje do të kërkojnë një VNM të thelluar vetëm nëse ndryshimi apo shtyrja ka të ngjarë të kenë efekte të rëndësishme në mjedis. Megjithatë, rëndësia e çdo efekti duhet të konsiderohet në kontekstin e zhvillimit ekzistues.

3.1.2 Listat e kontrollit për raportin paraprak të VNM

35. Për t'u ardhur në ndihmë vendimarrësve në marrjen e vendimit për raportin paraprak të VNM në bazë të rasteve të veçanta, dy lista kontrolli janë përfshirë në Aneksin 1 të këtij Udhërrëfyesi. Këto lista kontrolli duhet të ndihmojnë dhe mbështesin procesin e vendosjes nëse një projekt ka të ngjarë të ketë efekte të rëndësishme në mjedis apo jo.
36. Lista e parë e kontrollit, një listë kontrolli për raportin paraprak të VNM, ofron një listë me pyetje rreth projektit dhe mjedisit të tij. Ajo mund të ndihmojë në përgjigjen e pyetjes "a ka të ngjarë ky projekt të ketë efekte të rëndësishme në mjedis?". Lista e dytë e

kontrollit, një listë kontrolli me kritere për vlerësimin e rëndësisë së efekteve në mjedis, është synuar të përdoret së bashku me listën e kontrollit për raportin paraprak të VNM.

37. Nuk ka asnjë rregull specifik që mund të përdoret për të vendosur nëse kërkohet apo jo një VNM e thelluar. Vendimet merren në bazë të rasteve të veçanta.
38. Në teori, nëse përgjigja e një pyetjeje në listën e kontrollit për raportin paraprak të VNM është “po” ka të ngjarë që të rezultohet në efekt madhor dhe në këtë rast mund të kërkohet një VNM e thelluar.
39. Megjithatë, si rregull i përgjithshëm, sa më shumë përgjigje “po” të ketë dhe sa më e madhe të jetë rëndësia e efekteve të identifikuara, atëherë aq më tepër ka mundësi që të kërkohet një VNM.
40. Çdo përgjigje që rezulton në “?” e cila tregon pasiguri rreth ndodhjes apo rëndësisë së efekteve, duhet të tregojë gjithashtu një vendim pozitiv filtrues (që do të thotë që kërkohet një VNM e thelluar) pasi procesi i VNM do të ndihmonte në sqarimin e pasigurisë.

3.2 Raporti i thelluar i VNM

41. Zhvilluesi ka përgjegjësinë të përgatisë një Raport të thelluar të VNM, megjithëse ai mund të përdorë konsulentë të çertifikuar për ta përgatitur atë.
42. Raporti i thelluar i VNM duhet të përfshijë informacionin e përcaktuar në Ligj, dhe aty ku duhet informacionin e specifikuar në Aneksin të Ligjit.
43. Raporti i thelluar i VNM duhet të përmbajë përshkrimin e plotë faktik të projektit. Megjithatë theksi i Aneksit IV të Ligjit vihet mbi efektet “kryesore” ose “të rëndësishme” të cilat mund të shkaktohen nga projekti.
44. Në shumë raste vetëm disa efekte do të jenë “të rëndësishme” dhe do të kenë nevojë të diskutohen me disa hollësi në Raportin e thelluar të VNM. Ndikimet e tjera mund të kenë pak ose aspak rëndësi për projektin në fjalë dhe do të nevojitet vetëm një trajtim i shkurtër për të treguar që është marrë në konsideratë lidhja e mundshme ndërmjet tyre. Ndërsa çdo Raport i thelluar i VNM duhet të përmbushë (respektojë) kërkesat e Ligjit, është e rëndësishme që të përgatitet mbi baza realiste dhe pa shtjellime të panevojshme.
45. Ligji kërkon gjithashtu që Raporti i thelluar i VNM të përmbajë një skicë të alternativave kryesore të studiuara nga zhvilluesi dhe arsyet kryesore për zgjedhjen e tij.
46. Lista e aspekteve të mjedisit të cilat mund të ndikohen konsiderueshëm nga një projekt përcaktohen në Ligj dhe përfshin: qeniet njerëzore; florën; faunën; tokën; ujin; ajrin; klimën; peisazhin; asetet materiale, përfshirë trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike; si edhe ndërveprimin ndërmjet të gjitha aspekteve të mësipërme.
47. Ligji demonstroi, ndërmjet të tjerash, që i duhet kushtuar vemendje gjithashtu edhe efekteve të mundshme të rëndësishme që rezultojnë nga përdorimi i burimeve natyrore, shkarkimi i ndotësve, krijimi i shqetësimeve dhe eliminimi i mbetjeve.
48. Përveç efekteve të drejtpërdrejta të një zhvillimi, Raporti i thelluar i VNM duhet të mbulojë indirekt, efektet dytësore, të akumuluar, afat shkurtra, afat mesme e afat gjata, positive dhe negative.

49. Këto janë lista gjithëpërfshirëse, dhe një projekt i veçantë mund të shkaktojë, sigurisht, efekte të rëndësishme, dhe kërkon vlerësim të plotë dhe të hollësishëm, vetëm për një apo dy aspekte.
50. Informacioni në Raportin e thelluar të VNM duhet të përmbledhet në një përmbledhje jo teknike. Kjo përmbledhje jo teknike është veçanërisht e rëndësishme për t'u siguruar që publiku mund të bëjë komentet e veta mbi Raportin e thelluar të VNM dhe projektin. Raporti mund, sipas nevojës, të përmbajë të dhëna dhe analiza shkencore komplekse në një formë që nuk është menjëherë e kuptueshme për njerëzit që nuk janë profesionistë. Përmbledhja jo teknike duhet të parashtrojë gjetjet kryesore të Raportit të thelluar të VNM në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme.

3.2.1 Përmbajtja e Raportit të Thelluar të VNM

51. Nuk është detyrim për zhvilluesin të konsultohet me ndonjë për përmbajtjen dhe hollësitë e Raportit të thelluar të VNM (objektin e tij). Megjithatë, ekzistojnë arsye të mira për të vepruar kështu. Nëse Ministria konstaton më pas se informacioni i dhënë në Raportin e thelluar të VNM ka gabime apo mangësi, zhvilluesit do t'i duhet t'i rikthehet dhe të japë më tepër informacion.
52. Autoritetet e pushtetit vendor shpesh mund të kenë informacion të dobishëm e të specializuar dhe mund të jenë në gjendje të nxjerrin në pah fushat me shqetësim të veçantë.
53. Zhvilluesi është në gjendje të marrë një vendim paraprak për raportin e thelluar VNM nga Ministria. Nëse vepron kështu, ndoshta ai duhet t'i ofrojë Ministrisë një skicë të Raportit të thelluar të VNM duke dhënë indikacion se cili është mendimi i tij mbi problemet kryesore. Kjo do të ndihmonte të sigurohej fokusi për mendimin paraprak për raportin e thelluar VNM.
54. Ministria duhet të konsultohet me autoritetet e specifikuar përpara se të japë mendimin e vet paraprak për raportin e thelluar të VNM. Fakti që Ministria ka dhënë një mendim paraprak për raportin e thelluar VNM nuk do ta parandalojë Ministrinë të jetë në gjendje pyesë për informacion të mëtejshëm, nëse nevojitet, kur dorëzohet Raporti i thelluar i VNM.

3.2.2 Raporti i thelluar VNM Scoping

55. Qëllimi i raportit të thelluar të VNM është të identifikojë çështjet të cilat duhen mbuluar në informacionin mjedisor (Raporti i thelluar i VNM) të dorëzuar në Ministri nga zhvilluesi dhe, në veçanti të identifikojë çështjet që kanë më shumë rëndësi në mënyrë të tillë që këto të adresohen me më shumë detaje. Raporti i thelluar i VNM duhet të sigurojë që të gjitha çështjet përkatëse janë identifikuar dhe adresuar në mënyrën e duhur në studimet mjedisore.
56. Efektet në mjedis të një projekti gjatë fazave të tij të ndertimit dhe instalimit / përdorimit të parë të impiantit duhen marrë në konsideratë në mënyrë të veçantë nga efektet që lindin kur ai është operacional (nëse ai projekt ka një fazë 'operacionale').
57. Në rastet kur jeta operationale e projektit pritët të kufizohet, efektet e çinstalimit / mbylljes së operationeve ose rehabilitimit të tokës duhet të merren në konsideratë në mënyrë të veçantë.
58. Në rastet kur janë marrë në konsideratë përjasje alternative për projektin, zhvilluesit i kërkohet me Ligj të përfshijë në Raportin e thelluar të VNM një skicë të alternativave

kryesore dhe arsyeve kryesore për zgjedhjen e tij. Megjithëse Ligji nuk i kërkon shprehimisht zhvilluesit të studiojë alternativat, natyra e disa projekteve dhe vendodhja e tyre mund ta bëjë të rëndësishëm shqyrtimin e terreneve alternative. Në raste të tilla Raporti i thelluar i VNM duhet të përfshijë një regjistrim të marrjes në konsideratë të terreneve alternative. Më zakonisht, shqyrtimi i alternativave (përfshirë terrenet alternative, zgjedhjen e procesit dhe fazimin e ndërtimit) shihet gjerësisht si praktikë e mirë.

3.2.3 Lista e kontrollit për Raportin e thelluar të VNM

59. Prandaj Raporti i thelluar i VNM fokusohet pikë së pari në identifikimin e ndikimeve që duhet të vlerësohen dhe se cilat prej tyre janë të rëndësishme, por gjithashtu mund të adresojë disa prej ose të gjitha çështjet e mëposhtme:
 - llojet e alternativave që duhet të shqyrtohen;
 - studimet bazë që kërkohen të karakterizojnë mjedisin ekzistues;
 - çdo kërkesë speciale për studime bazë në lidhje me shtrirjen e tyre gjeografike ose përcaktimin e kohës që do të thotë për shkak të ndryshimeve sezonale tek fauna dhe flora;
 - nivelin e detajeve të investigimeve të kërkuara;
 - metodat që përdoren për parashikimin e shkallës së efekteve në mjedis;
 - kriteret kundrejt të cilave rëndësia e efekteve duhet vlerësuar;
 - llojet e minimizimit që duhen shqyrtuar;
 - çdo konsultim të mëtejshëm që duhet kryer gjatë studimeve mjedisore;
 - strukturën, përmbajtjen dhe gjatësinë e informacionit mjedisor (ose Raportit);
 - anëtarësinë dhe menaxhimin e ekipit të VNM;
 - planin e punës dhe gjetjen e burimeve për studimet mjedisore.
60. Tre listat e kontrollit janë dhënë në Aneksin 2 për t'i ardhur në ndihmë raportit të thelluar të VNM.
61. Lista e kontrollit për raportin e thelluar të VNM (Aneksi 2.A) përbëhet nga dy pjesë: Pjesa e parë ofron një listë të detajuar të karakteristikave të projekteve të cilat shkaktojnë efekte të rëndësishme në mjedis. Pjesa e dytë ofron një listë të karakteristikave të mjedisëve të projekteve të cilat mund të jenë të predispozuara ndaj efekteve negative të rëndësishme.
62. Një listë kontrolli për vlerësimin e rëndësisë së efekteve mjedisore (Aneksi 2.B). Kjo ofron një listë të faktorëve që duhen shqyrtuar kur vendoset nëse ka të ngjarë apo jo që një ndikim të jetë i rëndësishëm.
63. Një listë kontrolli mbi alternativat dhe masat e minimizimit (Aneksi 2.C). Këto duhen marrë në konsideratë gjithashtu në ushtrimin e raportit të thelluar të VNM.
64. Nuk duhet harruar që shqyrtimi i alternativave mund të duhet të konsiderohet në kontekstin e vendodhjeve alternative dhe, ose proceseve alternative.
65. Vendimi për zgjedhjen e terrenit duhet të bazohet në shqyrtimin e sa më shumë të jëtë e mundur llojeve të ndikimeve mjedisore për të cilët ka të dhëna të disponueshme.
66. Shqyrtimi i alternativave ndoshta do të duhet të përfshijë shqyrtimin e faktorëve të tjerë që kanë lidhje, siç janë efektshmëria e koston dhe potenciali për minimizim.

3.2.4 Ndikimet jo të drejtëpërdrejta dhe të akumuluar dhe bashkëveprimet e ndikimeve

67. Ligji kërkon që Raporti i thelluar i VNM të përmbajë një përshkrim të efekteve të mundshme të rëndësishme të projektit në mjedis. Ky përshkrim duhet të mbulojë efektet e drejtpërdrejta dhe të gjitha efektet jo të drejtpërdrejta, sekondare, të akumuluar, afat shkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të përhershme dhe të përkohshme, positive dhe negative të projektit. Përshkrimi duhet të mbulojë gjithashtu ndër-marrëdhëniet midis ndikimeve (bashkëveprimet e ndikimeve).
68. Kjo pjesë e Udhërrëfyesit fokusohet në dhënien e udhëzimeve për ndikimet jo të drejtpërdrejta dhe të akumuluar dhe për bashkëveprimet e ndikimeve.
69. Këto terma nuk janë përkufizuar në Ligj. Nuk ka përkufizime për të cilat është rënë dakord dhe janë pranuar në rang ndërkombëtar. Megjithatë, interpretimet e mëposhtme mund të jenë të dobishme.
70. **Ndikimet jo të drejtpërdrejta.** Ndikimet në mjedis, që nuk janë rezultat i drejtpërdrejtë i projektit, shpesh krijohen larg projektit ose si rezultat i një rruge komplekse. Shembuj të ndikimeve jo të drejtpërdrejta përfshijnë:
- Një projekt ndryshon ujin e pijshëm dhe kështu prek një ligatinë të afërt duke shkaktuar ndikim në ekologjinë e asaj ligatine;
 - Pengesat e pakësimit të zhurmave të përdorura si masë minimizuese rezultojnë më pas në një ndikim pamor;
 - Zhvillimi i një projekti vetë tërheq projektet të tjera ose ndihmëse.
71. **Ndikimet e akumuluar.** Ndikimet që rezultojnë nga ndryshimet shtesë të shkaktuara nga veprime të kaluara, të tashme apo arsyeshëm të parashikueshme së bashku me projektin. Shembuj të ndikimeve jo të akumuluar përfshijnë:
- Zhurmat shtesë nga një numër i veçantë projektesh;
 - Efektet e kombinuara të ndikimeve individuale që nënkuptojnë zhurmën, pluhurin dhe pamjen, nga një projekt në një marrës të caktuar;
 - Disa projekte me ndikime të parëndësishme në mënyrë individuale, por të cilët sëbashku kanë një efekt të akumuluar, që do të thotë zhvillimi i një kursi golfi mund të ketë një ndikim të parëndësishëm, por kur merret në konsideratë bashkë me disa kurse golfi që zhvillohen aty afër, mund të ketë një ndikim të akumuluar të rëndësishëm në ekologjinë lokale dhe peisazh.
72. **Bashkëveprimet e ndikimeve.** Veprimet ndërmjet ndikimeve, midis ndikimeve të vetëm një projekti apo midis ndikimeve të projekteve të tjera në zonë. Shembuj të bashkëveprimeve të ndikimeve mund të përfshijnë:
- Një impiant kimik që prodhon dy lloj rrymash mbetjesh që janë të pranueshme individualisht, por që ndërveprojnë kur kombinohen duke prodhuar nivele tepër të konsiderueshme ndotjeje;
 - Shkarkimet në ajër nga një projekt që ndërveprojnë me shkarkimet nga një zhvillim ekzistues.
 - Dy projekte madhore që janë në ndërtim e sipër pranë njeri tjetrit dhe gjatë periudhave kohore mbivendosëse do të kenë shumë ndikime bashkëvepruese, duke filluar nga problemet e përdorimit të tokës deri tek ndërtimi dhe zhurmat e punës.
73. Është e rëndësishme gjithashtu të shqyrtohen **ndikimet e ndër-mjeteve**. Një ndikim që prek një mjet mjedisor mund të ketë ndikim jo të drejtpërdrejtë edhe në mjete të tjera. Ky efekt jo i drejtpërdrejtë shpeshherë mund të jetë më i rëndësishëm se sa efekti i drejtpërdrejtë. Për shembull, në disa raste, ndryshimet në nivelet e zhurmave ose dridhjeve mund të kenë efekte të rëndësishme në foletë e zogjve dhe kafshëve të tjera. Ndërsa zhurma shtesë mund të mos përbëjë një rritje të rëndësishme kur përdoren metodat e thjeshta të vlerësimit, ndikimet indirekte në ekologji mund të jenë të rëndësishme.

74. Ndikimet pamore mund të kenë gjithashtu një ndikim jo të drejtpërdrejt në vlerën e komoditetit të terrenit me interes historik ose kulturor. Pa analizën e ndikimeve jo të drejtpërdrejta, ndërhyrja pamore mund të mos konsiderohet si e rëndësishme. Megjithatë, ndikimet jo të drejtpërdrejta mund të konsiderohen si të rëndësishme.
75. Është përtej objektit të këtij Udhërrëfyesi të trajtojë më hollësi metodat dhe mjetet që janë të disponueshme për vlerësimin e ndikimeve jo të drejtpërdrejta dhe të akumuluar si edhe të bashkëveprimeve të ndikimeve. Komisioni Evropian ka dhënë disa udhëzime të dobishme që mund të jenë me interes. *“Udhëzimet për vlerësimin e ndikimeve jo të drejtpërdrejta dhe të akumuluar si edhe bashkëveprimet e ndikimeve”*, Maj 1999.
76. Megjithatë, disa komente mund të bëhen këtu rreth efekteve jo të drejtpërdrejta dhe të akumuluar dhe bashkëveprimeve të ndikimeve, veçanërisht në lidhje me raportin e thelluar të VNM.
77. Gjatë procesit të raportit të thelluar të VNM është e rëndësishme të jemi të sensibilizuar për nevojën për të adresuar ndikime të tilla sipas projektit. Të qenit të sensibilizuar për potencialin e ndikimeve të tilla në një fazë të hershme të procesit, do të na ndihmonte të siguroheshim që mbledhja e informacionit përkatës siç janë të dhëna fillestare bazë, nevojat për vlerësim dhe burimet e kërkuara, janë marrë parasysh siç duhet.
78. Elementët kyç për raportin e thelluar të VNM në këtë aspekt përfshijnë:
- Përcaktimin e kufijve gjeografikë dhe kohorë për vlerësimin;
 - Përcaktimin në hartë i kufijve;
 - Mbledhja e të dhënave fillestare bazë;
 - Vlerësimi i ndikimeve.
79. Për procesin e raportit të thelluar të VNM është e rëndësishme të përcaktohet kufiri ose 'limiti' për atë pjesë të Raportit të thelluar të VNM që do të merret me vlerësimin e ndikimeve jo të drejtpërdrejta dhe të akumuluar dhe bashkëveprimeve të ndikimeve. Kufij të tillë duhet të përcaktohen mbi bazë projekti. Ekzistojnë dy lloje kufijsh që duhen marrë në konsideratë: kufiri gjeografik ose 'hapësinor'; dhe kufiri kronologjik ose kufiri i 'harkut kohor'.
80. Ndikimet jo të drejtpërdrejta dhe të akumuluar dhe bashkëveprimet e ndikimeve mund të shtrihen më së miri përtej kufijve të terrenit gjeografik të projektit. Prandaj është thelbësore të vendosen kufijtë gjeografikë për vlerësimin për të siguruar që ndikimet e lidhura me një projekt vlerësohen në mënyrë gjithëpërfshirëse kurdo që është e mundur.
81. Kufijtë gjeografikë do të varen nga:
- Natyra e projektit;
 - Natyra e ndikimit;
 - Ndjeshmëria e mjedisit pritës;
 - Disponueshmëria e të dhënave;
 - Kufijtë natyrorë.
82. Për shembull, kufiri gjeografik për vlerësimin e cilësisë së ajrit nga punimet në trajtimin e ujërave të zeza mund të vendoset nga prania e një zone banimi. Në mënyrë krahasimore, kufiri gjeografik për ndikimet në trafik si rezultat i një zhvillimi të ri madhor industrial mund të mbulojë një zonë shumë më të gjerë gjeografike në bazë të rrjetit rrugor local apo edhe rajonal.
83. Gjithashtu, është e nevojshme të shqyrtohen të gjitha ndikimet historike apo potenciale të ardhshme që mund të ndikojnë vlerësimin e projektit. Aktivitetet në të kaluarën, tashmen dhe të ardhmen mund të kenë të gjitha ndikim tek projekti që është duke u vlerësuar dhe do të influencojnë kuadrin kohor të caktuar për Raportin e thelluar të

VNM. Përcaktimi i kufijve kronologjikë apo kuadrit kohor do të lejonte përfshirjen e zhvillimeve të kaluara dhe të ardhme të cilat do të conin në ndikime jo të drejtpërdrejta apo të akumuluar ose bashkëveprime të ndikimeve.

84. Kufijtë kohorë do të varen nga:

- a. Përdorimi historik i zonës, për shembull aktivitetet industrial ose lëndfilllet;
- b. Informacioni i disponueshëm;
- c. Horizontal e planifikimit lokal apo kombëtar për zhvillime të ardhshme;

Shtirja kohore e projektit nga ndërtimi në çinstalimin/mbylljen e operacioneve.

85. Nga pikëpamja praktike, se sa larg do të shkojë niveli i vlerësimit për sa i përket të shkuarës dhe së ardhmes do të varet nga disponueshmëria dhe cilësia e informacionit. Aktivitetet e kaluara shpesh mund të identifikohen nga hartat historike, aktivitetet e tashme nga hartat aktuale dhe aktivitetet e zhvillimeve të ardhme nga planet e zhvillimit.

86. Se sa mbrapa në kohë do të duhet të shqyrtohet informacioni do varet nga projekti dhe përdorimi historik i zonës. Për shembull, në një zonë që ka pasur histori ndotje afatgjatë nga aktivitetet industriale ose lëndfilli mund të jetë e nevojshme të përcaktohen kufij kohorë deri në 50 apo 100 vjet më parë.

87. Përcaktimi i kufijve kohorë për sa i përket zhvillimeve të ardhshme mund të bazohet në informacionin e dhënë nga autoritetet përkatëse të planifikimit dhe nga informacioni që përmbahet brenda planeve të zhvillimit hartuar nga autoritetet lokale, rajonale apo kombëtare. Për shkak të pasigurisë që lidhet me shumë propozime apo plane të zhvillimeve të ardhshme, ka mundësi të mos jetë e përshtatshme të përcaktohen kufij kohorë për të ardhmen më shumë se pesë vjet për pjesën dërrmuese të rasteve.

88. Shtirja kohore e projektit aktual, nga ndërtimi deri tek çinstalimi / mbyllja e operacioneve dhe restaurimi, mund të konsiderohet e arsyeshme mbi të cilën të bazohet vlerësimi i këtyre lloj ndikimesh, veçanërisht atje ku mund të ketë një shtirje kohore të caktuar, për shembull për guroret apo lëndfillin. Megjithatë, kjo mund të provojë që të jetë më e vështirë për projektet që nuk kanë shtirje kohore kaq specifike siç janë rrugët.

89. Ekzistojnë kufizime në përcaktimin e kufijve kohorë dhe të zonës që mund të preken nga projekti. Për shembull, mund të jetë vetëm e arsyeshme për të shqyrtuar ngjarjet aktuale dhe ato që do të ndodhin në të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, vlerësimi vetëm mund të bazohet tek të dhënat që janë ndërkohë të disponueshme.

90. Duhet të ketë një pikë ndarëse në të cilën mund të thuhet se ndikimet nuk mund të jenë shkaktuar llogjikisht nga projekti. Kjo gjë duhet përcaktuar. Për shembull, kjo mund të jetë pika përtej së cilës nuk mund të ketë më minimizim të arsyeshëm. Raporti i thelluar i VNM duhet të përcaktojë pikën ndarëse të përdorur në vlerësim.

91. Mund të jetë e dobishme për zhvilluesin të përcaktojë në hartë kufijtë gjeografik dhe kohor për të treguar zonat me ndikim potencial të cilat mund të mbivendosen dhe për rrjedhojë aty ku ndikimet jo të drejtpërdrejta dhe të akumuluar ose bashkëveprimet e ndikimeve mund të ndodhin.

92. Kufijtë gjeografik mund të përcaktohen në hartë për të treguar se cilat zona do të shqyrtohen në vlerësimin e secilës temë apo parametër mjedisor. Në shqyrtimin e "kufijve kohorë", përdorimi i shkuar, i tashëm dhe i ardhshëm i tokës mund të përcaktohet në hartë në të njëjtën mënyrë.

93. Gjithashtu, zhvilluesi gjatë procesit të raportit të thelluar të VNM, duhet të shqyrtojë se çfarë të dhënash fillestare bazë do të kërkohen. Disa të dhëna fillestare bazë duhet të mblidhen në këtë fazë që të ndimohen në identifikimin e ndikimeve potenciale dhe

marrësve të ndjeshëm. Gjithashtu, duhet të identifikohen të gjitha mungesat apo mangësitë tek të dhënat të cilat mund të rezultojnë në kërkesa për anketime shtesë.

94. Është e rëndësishme në këtë fazë të hershme të projektit të vendoset nëse duhet të mblidhen të dhëna shtesë apo nëse nevojitet të kryhet ndonjë anketim për të lejuar vlerësimin e ndikimeve jo të drejtpërdrejta dhe të akumuluar si dhe bashkëveprimeve të ndikimeve.

3.2.5 Lista e kontrollit e çështjeve që duhen konsideruar për përfshirje në një Raport të thelluar të VNM

95. Aneksi 3 përcakton një listë kontrolli të çështjeve që duhen konsideruar për përfshirje në një Raport të thelluar të VNM. Kjo listë kontrolli mund të jetë ndihmesë për zhvilluesin për të siguruar që ai ka përfshirë të gjithë informacionin përkatës me hollësi të mjaftueshme.

3.3 Rishikimi i Raportit të thelluar të VNM

96. Ligji përcakton hollësitë se çfarë duhet përfshirë në Raport dhe çfarë duhet përfshirë vetëm nëse ka lidhje me një projekt të caktuar. Nuk ka gjasa që çdo zë i përmendur në Ligj të ketë lidhje me një projekt të caktuar (kjo është arsyeja pse raporti i thelluar i VNM është kaq i rëndësishëm).

97. Pasi Ministria merr kopjet e Raportit të thelluar të VNM, kryen vlerësimin e parë. Vlerësimi i parë nuk është një vlerësim i hollësishëm, por bëhet që të sigurojë që nga pikëpamja administrative, zhvilluesi ka dorëzuar një Raport në përputhje me Ligjin.

98. Nëse, gjatë rishikimit të parë, Ministria konstaton që i duhet më shumë informacion për të dhënë mendimin e saj mbi projektin e propozuar dhe mbi Raportin e thelluar të VNM, ajo mund ta kërkojë këtë informacion shtesë nga zhvilluesi.

99. Ministria duhet t'i dërgojë kopjet e Raportit, dhe çdo informacion shtesë tek AMP, autoritetet vendore dhe tek disa autoritete të tjera për komentet dhe sugjerimet e tyre. Ligji gjithashtu përcakton procesin e konsultimit me publikun.

100. Ministria duhet të japë Mendimin e saj mbi projektin e propozuar, duke marrë parasysh Raportin e thelluar të VNM dhe strukturën, skopin, shkallën, madhësinë, kapacitetin dhe vendodhjen e projektit të planifikuar si edhe ndikimet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të projektit të propozuar. Kur jep mendimin e vet, Ministria duhet të marrë parasysh gjithashtu çdo koment apo sugjerim të marrë nga cilido autoritet tjetër apo nga publiku.

101. Rishikimi i parë i Raportit të thelluar të VNM nga Ministria do të ndihmojë të përcaktojë nëse informacioni i dorëzuar nga zhvilluesi në Raport është i mjaftueshëm për Ministrinë që të japë Mendimin e saj. Kjo pjesë e Udhërrëfyesit përcakton disa udhëzime për rishikimin e Raportit të thelluar të VNM.

102. Aneksi 4 përcakton një Listë Kontrolli Rishikimi e cila synon të ndihmojë kontrollojë mjaftueshmërinë e informacionit të dhënë në Raportin e thelluar të VNM: që do të thotë, nëse informacioni i dhënë është i plotë dhe i mjaftueshëm nga pikëpamja e përmbajtjes

dhe mendimdhënies. Sigurisht, nëse informacioni nuk është i mjaftueshëm, Ministria duhet të kërkojë nga zhvilluesi informacion shtesë.

103. Lista e Kontrollit e Rishkimit duhet të ndihmojë gjithashtu të sigurojë që informacioni i dhënë nga zhvilluesi është në formatin e duhur kështu që publiku do të jetë në gjendje të japë komente të dobishme mbi projektin dhe ndikimet e tij në mjedis.
104. Një raport i mire i thelluar i VNM do të shkruhet në mënyrë që t'u japë informacion të mirë dy audiencave kryesore: Ministrisë (si Mendimdhënëse) dhe njerëzve potencialisht të prekur nga projekti.
105. Ndërsa Raporti i thelluar i VNM duhet, patjetër, të përmbushë (respektojë) kërkesat e Ligjit, ai duhet gjithashtu të:
- a. Ketë një strukturë të qartë me një rrjedhë llogjike për shembull, të përshkruajë kushtet ekzistuese bazë, ndikimet e parashikuara (natyrën, shkallën dhe madhësinë), objektin për minimizim, masat e rëna dakord për minimizim, rëndësinë e ndikimeve të pashmangshme / të mbetjeve për çdo temë mjedisore.
 - b. Ketë përmbajtjen e lëndës në fillim të dokumentit.
 - c. Ketë një përshkrim të qartë të procedurës për leje zhvillimi dhe mënyrës se si VNM përshtatet me të.
 - d. Lexohet si një document i vetëm me ndër-referencat e duhura.
 - e. Jetë konçiz, gjithëpërfshirës dhe objektiv.
 - f. Jetë shkruar në mënyrë asnjëse pa mbajtur qëndrime.
 - g. Përfshijë përshkrim të plotë të propozimeve të zhvillimit.
 - h. Përdorë efektivisht diagramat, ilustrimet, fotografitë dhe grafikë të tjerë në mbështetje të tekstit.
 - i. Përdorë terminologji të qëndrueshme për sa i përket fjalorit.
 - j. Përmbajë referenca për të gjitha burimet e informacionit që janë përdorur.
 - k. Ketë një shpjegim të qartë të çështjeve komplekse.
 - l. Përmbajë një përshkrim të mirë të metodave të përdorura për studimet e çdo teme mjedisore.
 - m. Mbulojë çdo temë mjedisore në mënyrë proporcionale me rëndësinë e saj.
 - n. Japë prova për konsultime të mira.
 - o. Përfshijë një diskutim të qartë mbi alternativat.
 - p. Marrë angazhim për minimizimin (me anë të një programi) dhe monitorimin.
 - q. Ketë një Përmbledhje Jo Teknike e cila të mos përmbajë zhargone teknike.

Aneksi 1 Listat e kontrollit për Raportin Paraprak të VNM

1. Një listë kontrolli për raportin paraprak¹ të VNM

Udhëzime për përdorimin

Kjo listë kontrolli është hartuar të ndihmojë përdoruesit të vendosin nëse kërkohet apo jo një VNM e thelluar për një projekt të caktuar, bazuar në karakteristikat e projektit dhe mjedisit të tij.

1. Filloni duke dhënë një përshkrim të shkurtër të projektit.
2. Më pas duke përdorur informacionin e disponueshëm rreth projektit, përgjigjuni çdo pyetjeje në kolonën 2. Përgjigjet duhet të jenë ose:
 - a. Po
 - b. Jo, ose
 - c. ?, nëse nuk e dini apo nuk jeni të sigurt për përgjigjen
3. Nëse ka ndonjë pasiguri në lidhje me çfarë është e rëndësishme, lista e detajuar e pyetjeve në listën e kontrollit për raportin e thelluar të VNM (më poshtë) mund të ndihmojë t'i përgjigjeni pyetjes.
4. Gjithashtu në kolonën 2 përshkruani shkurtimisht karakteristikat përkatëse të projektit ose mjedisit të tij.
5. Më tej shqyrtoni nëse ndonjë efekt që është identifikuar si i mundshëm, ka të ngjarë të jetë i rëndësishëm gjithashtu dhe e vendosni përgjigjen në kolonën 3.
6. Gjithashtu në kolonën 3, jepni shkurtimisht arsyet për përgjigjen.
7. Lista e kontrollit për kriteret e vlerësimit të rëndësisë (Aneksi 1.B) mund të ndihmojë t'i përgjigjeni pyetjes “a ka të ngjarë që kjo të rezultojë në efekt të rëndësishëm?”

Pyetje që duhen marrë në konsideratë	Po/Jo Përshkruani shkurtimisht	A ka të ngjarë që kjo gjë të rezultojë në efekt të rëndësishëm? Po/Jo? Pse?
<i>Përshkrim i Shkurtër i Projektit</i>		
1. A do të përfshijë ndërtimi, operimi apo çinstalimi / mbyllja e operacioneve të Projektit veprime që do të shkaktojnë ndryshime fizike në zonë (topografi, përdorimi i tokës, ndryshime në trupat		

¹ Këto Lista Kontrolli Paraprak janë marrë nga Udhërrëfytyesi i Komisionit Evropian për Raportin Paraprak të VNM, Qershor 2001

Pyetje që duhen marrë në konsideratë	Po/Jo Përshkruani shkurtimisht	A ka të ngjarë që kjo gjë të rezultojë në efekt të rëndësishëm? Po/Jo? Pse?
ujorë, etj)?		
2. A do të përdorë ndërtimi apo operimi i Projektit burime natyrore si toka, uji, materiale apo energji, veçanërisht ndonjë burim që nuk është i rinovueshëm apo i pakët në sasi?		
3. A do të përfshijë Projekti përdorimin, magazinimin, transportin, dorëzimin apo prodhimin e substancave a materialeve që mund të jenë të dëmshme për shëndetin e njeriut apo mjedisin apo që mund të krijojnë problem mbi risqet aktuale ose ato të perceptuara ndaj shëndetit të njeriut?		
4. A do të prodhojë mbetje të ngurta Projekti gjatë ndërtimit ose operimit ose çinstalimit/mbylljes së operacioneve?		
5. A do të çlirojë Projekti në ajër ndotës apo ndonjë substancë të rrezikshme, toksike apo helmuese?		
6. A do të shkaktojë Projekti zhurma dhe dridhje apo çlirojë dritë, energji nxehtësie apo rrezatim elektromagnetik?		
7. A do të çojë Projekti në rreziqe ndotje për tokën apo ujin nga çlirimi i ndotësve në tokë apo ujërat sipërfaqësore, tokësorë, bregdetarë apo detar?		
8. A do të ketë ndonjë risk për aksident gjatë ndërtimit apo operimit të Projektit që do të ndikojë shëndetin e njeriut apo mjedisin?		
9. A do të rezultojë Projekti në ndryshime sociale, për shembull, në demografi, stilet tradicionale të jetesës, punësim?		
10. A ekzistojnë faktorë që duhen marrë në konsideratë si zhvillimi resultant që mund të çojë në efekte mjedisore apo potenciali për ndikime të akumuluarra së bashku me aktivitete ekzistuese apo të planifikuara në zonë?		
11. A ka zona në apo përreth vendodhjes që janë të mbrojtura në bazë të legjislacionit ndërkombëtar, kombëtar apo lokal për vlerat e tyre ekologjike, kulturore, peisazhin apo ndonjë vlerë tjetër, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?		
12. A ka zona të tjera në apo përreth vendodhjes që janë të rëndësishme apo të ndjeshme për arsye të ekologjisë së tyre për shembull: ligatina, rrjedha ujore apo trupa të tjerë ujorë, zona bregdetare, male, pyje apo zona me dru (pemishte) , të cilat		

Pyetje që duhen marrë në konsideratë	Po/Jo Përshkruani shkurtimisht	A ka të ngjarë që kjo gjë të rezultojë në efekt të rëndësishëm? Po/Jo? Pse?
mund të ndikohen nga Projekti?		
13. A ka zona në apo përreth vendodhjes që përdoren nga specie të mbrojtura, të rëndësishme apo të ndjeshme të florës ose faunës për shembull: për mbarështimin, krijimin e foleve, kërkimin për ushqimin, pushimin, (letargjinë) gjumin dimëror, migrimin, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?		
14. A ka ujëra në tokë, bregdetare, marine apo nëntokësore në apo përreth vendodhjes, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?		
15. A ka zona apo tipare të vlerave të peisazheve të larta apo të vlerave skenike në apo përreth vendodhjes, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?		
16. A ka rrugë apo lehtësira në apo përreth vendodhjes që përdoren nga publiku si hyrje për në qendrat argëtuese apo lehtësira të tjera, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?		
17. A ka rrugë transporti në apo përreth vendodhjes që janë të prirura ndaj bllokimit apo që mund të shkaktojnë problem mjedisore, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?		
18. A është projekti në një vendodhje që ka mundësi të jetë shumë i dukshëm për shumë njerëz?		
19. A ka zona apo tipare të rëndësishme historike a kulturore në apo përreth vendodhjes, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?		
20. A është projekti i vendosur në një zonë të pazhvilluar më parë ku do të ketë humbje të tokës së gjelbër?		
21. A ka përdorim ekzistues të tokës në apo përreth vendodhjes për shembull: shtëpi, kopshte, prona të tjera private, industry, tregti, vende argëtimi, hapësira të hapura publike, lehtësira për komunitetin, bujqësi, pylltari, turizëm, miniera apo gurore, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?		
22. A ka plane për përdorimin e ardhshëm të tokës në apo përreth vendodhjes, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?		
23. A ka zona në apo përreth vendodhjes që janë dendësisht të populluara apo kanë shumë ndërtime, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?		

Pyetje që duhen marrë në konsideratë	Po/Jo Përshkruani shkurtimisht	A ka të ngjarë që kjo gjë të rezultojë në efekt të rëndësishëm? Po/Jo? Pse?
24. A ka zona në apo përreth vendodhjes që janë zënë nga përdorime të ndjeshme të tokës për shembull: spitale, shkolla, faltore, lehtësira për komunitetin, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?		
25. A ka zona në apo përreth vendodhjes që përmbajnë burime të rëndësishme, me cilësi të lartë apo burime të rralla për shembull: ujëra tokësorë, ujëra sipërfaqësore, pylltari, bujqësi, rritja e peshkut, turizëm, minerale, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?		
26. A ka zona në apo përreth vendodhjes që tashmë janë subjekt i ndotjes apo dëmtimeve mjedisore, për shembull atje ku janë tejkaluar standartet ligjore ekzistuese për mjedisin, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?		
27. A është vendodhja e projektit e prirur ndaj tërmeteve, ekzistencës, shkarjes së dheut, errozionit, përmytjeve apo kushteve klimaterike ekstreme ose negative për shembull ndryshimet e anasjellta të temperaturës, mjegulla, erërat e forta, që mund ta bëjnë projektin të shfaqë problem mjedisore?		

Aneks 1.B Lista e kontrollit e Krieteve për Vlerësimin e Rëndësisë së Efteve në Mjedis

Kjo listë kontrollit synon të ndihmojë përdoruesit të vendosin nëse kërkohet VNM e thelluar bazuar në karakteristikat e ndikimeve të mundshme të projektit. Ajo duhet përdorur së bashku me Listën e kontrollit për raportin paraprak të VNM (1.A).

Lista e kontrollit për raportin paraprak të VNM ndihmon të identifikohet ky ekziston potenciali për bashkëveprime midis një projekti dhe mjedisit. Kjo listë kontrollit ndihmon të vendoset nëse ka të ngjarë që këto bashkëveprime (efekte) të jenë të rëndësishme.

Pyetjet janë formuluar në mënyrë të tillë që një përgjigje “po” në përgjithësi do të tregojë nevojën për një VNM të thelluar, kurse një përgjigje “jo” në përgjithësi do të tregojë që nuk ka nevojë për një VNM të thelluar.

Pyetje që duhen marrë në konsideratë

1. A do të ketë një ndryshim të madh në kushtet mjedisore?
2. A do të jenë karakteristikat e reja jashtë balancës me mjedisin ekzistues?
3. A do të jetë efekti në zonë i pazakonshëm apo veçanërisht kompleks?
4. A do të shtrihet efekti në një zonë të madhe?
5. A do të ketë potencial për ndikime ndërkufitare?
6. A do të preken shumë njerëz?
7. A do të preken shumë marrës të llojeve të tjera (fauna dhe flora, bizneset, lehtësirat) ?
8. A do të preken karakteristikat apo burimet e çmuara ose të rralla?
9. A ekziston risku që të shkelen standartet mjedisore?
10. A ekziston risku që të preken vendet, karakteristikat, zonat e mbrojtura?
11. A ka probabilitet të lartë që të ndodhë efekti?
12. A do të vazhdojë efekti për një kohë të gjatë?
13. A do të jetë efekti i përhershëm më tepër sesa i përkohshëm?
14. A do të jetë ndikimi i vazhdueshëm më tepër sesa sporadik?
15. Nëse është sporadic do të jetë më tepër i shpeshtë sesa i rrallë
16. A do të jetë ndikimi i pakthyesëm?
17. A do të jetë e vështirë të shmanget, apo të pakësohet, të rregullohet a të kompensohet për efektin?

Aneksi 2 Listat e kontrollit për Raportin e Thelluar² të VNM

Aneksi 2.A.1 Karakteristikat e Projektit

Nr.	Pyetje që duhen marrë në konsideratë për raportin e thelluar të VNM	Po/Jo?	Cilat karakteristika të Projektit do të ndikonin në Mjedis dhe si?	A ka të ngjarë që efekti të jetë i rëndësishëm? Pse?
1	A do të përfshijë ndërtimi, operimi apo çinstalimi / mbyllja e operacioneve i Projektit veprime të cilat do të shkaktojnë ndryshime fizike në zonë (topografi, përdorimin e tokës, ndryshime në trupat ujore, etj.)?			
1.1	Ndryshime të përhershme apo të përkohshme në përdorimin e tokës, mbulimin e tokës apo topografinë përfshirë edhe rritjet në intensitetin e përdorimit të tokës?			
1.2	Pastrim i tokës, vegjetacionit dhe ndërtesave ekzistuese?			
1.3	Krijim i përdorimeve të reja të tokës?			
1.4	Investigime para-ndërtimore për shembull, puset, testimi i tokës?			
1.5	Punime ndërtimi?			
1.6	Punime shkatërrimi?			
1.7	Terrene të përkohshme të vërdorura për punime ndërtimi apo strehimin e punëtorëve të ndërtimit?			
1.8	Ndërtesa mbitokësore, struktura apo punime me dhë përfshirë struktura lineare, prerje dhe mbushje apo gërmime?			
1.9	Punime nëntokësore përfshirë nxjerrjen e mineraleve apo ndërtimin e tuneleve?			

² Këto Lista Kontrolli të thelluara janë marrë nga Udhërrëfytyesi i Komisionit Evropian për Raportin e Thelluar të VNM, Qershor 2001

Nr.	Pyetje që duhen marrë në konsideratë për raportin e thelluar të VNM	Po/Jo?	Cilat karakteristika të Projektit do të ndikonin në Mjedis dhe si?	A ka të ngjarë që efekti të jetë i rëndësishëm? Pse?
1.10	Punime bonifikuese?			
1.11	Pastrim?			
1.12	Struktura bregdetare për shembull mure detare, dok (vende ankorimi në port)?			
1.13	Struktura në det?			
1.14	Proçese prodhimi dhe manifakturimi?			
1.15	Lehtësira për magazinimin e mallrave apo materialeve?			
1.16	Impiante për trajtimin apo asgjësimin e mbetjeve të ngurta apo rrjedhjeve të lëngshme?			
1.17	Lehtësira për strehimin afatgjatë të punëtorëve operacionalë?			
1.18	Trafik i ri rrugor, hekurudhor apo detar gjatë ndërtimit apo operimit?			
1.19	Infrastrukturë e re rrugore, hekurudhore, ajrore, ujore apo transporti tjetër përfshirë rrugët dhe stacionet, portet, aeroportet e reja apo të alternuara, etj?			
1.20	Mbyllje apo ndryshim i rrugëve ekzistuese të transportit apo infrastrukturës që çon në ndryshime të lëvizjeve të trafikut?			
1.21	Linja apo tubacione transmisioni të reja apo të ndryshuara?			
1.22	Mbyllja, vendosja e digave, kanalizimet, ripozicionimi apo ndryshime të tjera në hidrologjinë e rrjedhave ujore apo zonat / shtresat ujëmbajtëse?			
1.23	Kalime përrrenjsh?			
1.24	Nxjerrje apo transferta të ujit nga ujërat tokësorë apo sipërfaqësorë?			
1.25	Ndryshime në trupat ujorë ose sipërfaqen e tokës që ndikojnë në kullimet apo apo derdhjet?			
1.26	Transporti i personelit ose materialeve për ndërtimin, operimin apo çinstalimin /			

Nr.	Pyetje që duhen marrë në konsideratë për raportin e thelluar të VNM	Po/Jo?	Cilat karakteristika të Projektit do të ndikonin në Mjedis dhe si?	A ka të ngjarë që efekti të jetë i rëndësishëm? Pse?
	mbylljen e operacioneve?			
1.27	Punime afatgjata çmontimi, çinstalimi / mbyllje e operacioneve apo restaurimi?			
1.28	Aktivitet i vazhdueshëm gjatë çinstalimit / mbylljes së operacioneve që mund të ketë ndikim në mjedis?			
1.29	Fluks i njerëzve që vijnë në një zonë përkohësisht apo përgjithmonë?			
1.30	Prezantim i specieve aliene?			
1.31	Humbje e specieve kombëtare apo diversitetit gjenetik?			
1.32	Veprime të tjera?			
2	A do të përdoren gjatë ndërtimit apo operimit të Projektit burime natyrore si toka, uji, material apo energji, veçanërisht ndonjë burim që nuk është i rinovueshëm apo i pakët në sasi?			
2.1	Tokë veçanërisht e pazhvilluar apo tokë bujqësore?			
2.2	Ujë?			
2.3	Minerale?			
2.4	Agregate?			
2.5	Pyll dhe dru?			
2.6	Energji përfshirë energji elektrike dhe karburantet?			
2.7	Burime të tjera?			
3	A do të përfshijë Projekti përdorimin, magazinimin, transportin, dorëzimin apo prodhimin e substancave apo materialeve që mund të jenë të rrezikshme për shëndetin e njeriut ose mjedisin apo që mund të shkaktojnë problem rreth risqeve aktuale apo të perceptuara ndaj shëndetit të njeriut?			
3.1	A do të përfshirë projekti përdorimin e substancave apo materialeve që janë të rrezikshme apo toksike për shëndetin e njeriut ose mjedisin (flora, fauna, furnizimi me ujë)?			
3.2	A do të rezultojë projekti në ndryshime në rastet e sëmundjeve apo do të ndikojë vektorët e sëmundjeve (për shembull sëmundjet me prejardhje nga insektet ose uji)?			
3.3	A do të ndikojë projekti tek			

Nr.	Pyetje që duhen marrë në konsideratë për raportin e thelluar të VNM	Po/Jo?	Cilat karakteristika të Projektit do të ndikonin në Mjedis dhe si?	A ka të ngjarë që efekti të jetë i rëndësishëm? Pse?
	mirëqenia e njerëzve për shembull duke ndryshuar kushtet e jetesës?			
3.4	A ka veçanërisht grupe njerëzish në rrezik (të pambrojtur) që mund të ndikohen nga projekti për shembull pacientet e spitalit, të moshuarit?			
3.5	Shkaqe të tjera?			
4	A do të prodhojë Projekti mbetje të ngurta gjatë ndërtimit, operimit dhe çinstalimit / mbylljes së operacioneve?			
4.1	Mbetje nga prishjet, ngarkesat apo minierat?			
4.2	Mbetje bashkiake (mbetje familjare dhe / ose tregtare)?			
4.3	Mbetje të rrezikshme ose toksike (përfshirë mbetjet radioaktive)?			
4.4	Mbetje të tjera nga procese industriale?			
4.5	Produkt i tepërt?			
4.6	Llumra nga ujërat e zeza ose llumra të tjerë nga trajtimi i efluentëve (mbetjet e lëngshme)?			
4.7	Mbetje nga ndërtimi ose shkatërrimi?			
4.8	Makineri apo pajisje jashtë funksionit?			
4.9	Toka apo materiale të tjera të ndotura?			
4.10	Mbetje bujqesore?			
4.11	Mbetje të tjera të ngurta?			
5	A do të çlirojë Projekti ndotës apo ndonjë substancë tjetër të rrezikshme, toksike apo helmuese në ajër?			
5.1	Shkarkime nga djegia e fosileve nga burimet e palëvizshme ose të lëvizshme?			
5.2	Shkarkime nga proceset e prodhimit?			
5.3	Shkarkime nga dorëzimi i materialeve përfshirë magazinimin ose transportin?			
5.4	Shkarkime nga aktivitetet e ndërtimit përfshirë impiantin dhe pajisjet?			
5.5	Pluhur apo erëra nga dorëzimi i materialeve përfshirë materialet e ndërtimit, ujërat e			

Nr.	Pyetje që duhen marrë në konsideratë për raportin e thelluar të VNM	Po/Jo?	Cilat karakteristika të Projektit do të ndikonin në Mjedis dhe si?	A ka të ngjarë që efekti të jetë i rëndësishëm? Pse?
	zeza dhe mbetjet?			
5.6	Shkarkime nga djegia / incinerimi i mbetjeve?			
5.7	Shkarkime nga djegia e mbetjeve në ambient të hapur (për shembull materiale të prera, mbetje nga ndërtimi)?			
5.8	Shkarkime nga burime të tjera?			
6	A do të shkaktojë Projekti zhurma dhe dridhje apo do të çlirojë dritë, energji nxehtësie apo rrezatim elektromagnetik?			
6.1	Nga operimi i paisjeve për shembull motorët, impiantetb e ventilimit, copëtuesit/grirësit?			
6.2	Nga procese industriale apo të ngjashme?			
6.3	Nga ndërtimet ose shkatërrimet?			
6.4	Nga shpërthimet apo stivosja?			
6.5	Nga trafiku i ndërtimit apo operacioneve?			
6.6	Nga sistemet e ndriçimit apo të ftohjes?			
6.7	Nga burimet e rrezatimeve elektromagnetike (shqyrtoni efektet mbi paisjet e afërta të ndjeshme si edhe njerëzit)?			
6.8	Nga burime të tjera?			
7	A do të çojë Projekti në risqe ndotjeje të tokës ose ujit nga çlirimi i ndotësve në tokë ose në kanalet e ujërave të zeza (gropat septike), ujërat sipërfaqësorë, tokësorë, bregdetarë ose në det?			
7.1	Nga dorëzimi, magazinimi, përdorimi ose derdhja e materialeve të rrezikshme ose toksike?			
7.2	Nga shkarkimi i ujërave të zeza ose ujërave të tjerë të ndotur (pavarësisht nëse janë apo jo të trajtuar apo të patrajtuar) në ujë ose në tokë?			
7.3	Nga depozitimi i ndotësve të shkarkuar në ajër, në tokë ose në ujë?			
7.4	Nga burime të tjera?			
7.5	A ekziston ndonjë risk për krijimin afatgjatë të ndotësve në mjedis nga këto burime?			
8	A do të ketë ndonjë risk për aksidente gjatë ndërtimit ose operimit të Projektit që mund të ndikojnë në shëndetin e njerëzve apo mjedis?			

Nr.	Pyetje që duhen marrë në konsideratë për raportin e thelluar të VNM	Po/Jo?	Cilat karakteristika të Projektit do të ndikonin në Mjedis dhe si?	A ka të ngjarë që efekti të jetë i rëndësishëm? Pse?
8.1	Nga shpërthimet, derdhjet, zjarret, etj. nga magazinimi, dorëzimi ose prodhimi i substancave të rrezikshme apo toksike?			
8.2	Nga ngjarjet përtej kufijve të mbrojtjes normale të mjedisit për shembull mosfunksionimi i sistemeve të kontrollit të ndotjes?			
8.3	Nga shkaqe të tjera?			
8.4	Mund të ndikohet projekti nga fatkeqësi natyrore që shkaktojnë dëme në mjedis (për shembull përmbytjet, tërmetet, shkarjet e dheut, etj. etc)?			
9	A do të rezultojë Projekti në ndryshime sociale, për shembull, në demografi, stilet tradicionale të jetesës, punësim?			
9.1	Ndryshime në madhësinë, moshën, strukturën e popullsisë, grupeve sociale, etj.?			
9.2	Nga rivendosja e njerëzve ose prishja e shtëpive ose komuniteteve ose lehtësirave të komunitetit për shembull shkollat, spitalet, lehtësirat sociale?			
9.3	Nëpërmjet migrimit / shpërnguljes së rezidentëve të rinj që vijnë apo krijimit të komuniteteve të reja?			
9.4	Nga vendosja e kërkesës së rritur për lehtësirat apo shërbimet lokale për shembull strehimi, arsimit, shëndetësia?			
9.5	Nga krijimi i punëve gjatë ndërtimit ose operimit ose shkaktimi i humbjes së punëve me efekte në papunësi dhe ekonomi?			
9.6	Shkaqe të tjera?			
10	A ekzistojnë faktorë të tjerë që duhen shqyrtuar siç janë zhvillimi rezultat që mund të çojë në efekte mjedisore ose potencial për ndikime të akumuluar bashkë me aktivitete të tjera ekzistuese apo të planifikuara në zonë?			
10.1	A do të çojë projekti në presion për zhvillime rezultante që mund të kenë ndikime të rëndësishme në mjedis për shembull më shumë strehim, rrugë të reja,			

Nr.	Pyetje që duhen marrë në konsideratë për raportin e thelluar të VNM	Po/Jo?	Cilat karakteristika të Projektit do të ndikonin në Mjedis dhe si?	A ka të ngjarë që efekti të jetë i rëndësishëm? Pse?
	industri apo shërbime të reja ndihmëse, etj.?			
10.2	A do të çojë projekti në zhvillimin e lehtësirave mbështetëse, zhvillim ndihmës ose zhvillim të stimuluar nga projekti që mund të kenë ndikim në mjedis, për shembull: <ul style="list-style-type: none"> • infrastrukturë ndihmëse (rrugë, furnizim me energji, trajtim mbetjesh ose ujërash të ndotur, etj.) • zhvillimi i strehimit • industri nxjerrëse • industri furnizuese • tjetër? 			
10.3	A do të çojë projekti në përdorimin e mëtejshëm të terrenit që mund të ketë ndikim në mjedis?			
10.4	A do të përcaktojë projekti një precedent për zhvillime të mëvonshme?			
10.5	A do të ketë projekti efekte të akumuluar për shkak të afërsisë me projekte të tjera ekzistuese ose të planifikuara me efekte të njëjta?			

Udhëzime për përdorim

Kjo listë kontrolli është hartuar që të ndihmojë përdoruesit të identifikojnë efektet e mundshme të rëndësishme në mjedis nga projektet e propozuara gjatë raportit të thelluar të VNM. Ajo duhet përdorur së bashku me Listën e kontrollit të kritereve për vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve (Aneksi 2.A.2).

Ka dy faza:

1. identifikimi i ndikimeve potenciale të projekteve;
2. përzgjedhja e atyre që ka të ngjarë të jenë të rëndësishme dhe si rrjedhojë kërkojnë më shumë vëmendje në vlerësim.

Një mënyrë e përdorshme për identifikimin e ndikimeve potenciale të një projekti është identifikimi i gjithë aktiviteteve apo burimeve të ndikimeve që mund të lindin nga ndërtimi, operimi apo çinstalimi / mbyllja e operacioneve të projektit dhe shqyrtimi i tyre bashkë me karakteristikat e mjedisit të projektit që mund të ndikohen, për të identifikuar ku mund të ketë bashkëveprime mes tyre. Për të ndihmuar këtë proces janë hartuar dy pjesë të Listës së kontrollit për raportin e thelluar të VNM.

1. Plotësoni kolonën 2 duke u përgjigjur:

- “po” – nëse aktiviteti ka të ngjarë të ndodhë gjatë zbatimit të projektit;
 - “jo” – nëse nuk pritet të ndodhë;
 - “?” – nëse është e pasigurt në këtë fazë nëse do të ndodhë apo jo.
2. Për çdo aktivitet për të cilin përgjigja në kolonën 2 është “po” ose “?”, përdorni listën e kontrollit në pjesën 2 (Annex 2.A.2) e cila rendit karakteristikat e mjedisit të projektit që mund të preken dhe identifikon çdo gjë që mund të ndikohet nga ai aktivitet. Me qëllim që të plotësohet kjo fazë do të nevojitet informacion për mjedisin rrethues.
 3. Vini re karakteristikat e mjedisit të projektit që mund të ndikohen dhe natyrën e efekteve potenciale në Kolonën 3.
 4. Së fundmi, përdorni Listën e Kontrollit të Kritereve për Vlerësimin e Rëndësisë së Ndikimeve (Aneksi 2.B) për të ndihmuar plotësimin e Kolonës 4. Kjo do të identifikojë ato ndikime që pritet të jenë të rëndësishme. Pyetjet janë hartuar në mënyrë të tillë që një përgjigje “po” do të tregojë një ndikim të rëndësishëm. Shpesh herë është e vështirë të vendosësh çfarë është ose jo e rëndësishme por një kontroll i thjeshtë i dobishëm duhet për të pyetur nëse efekti është i një rëndësie të mjaftueshme që do të duhet të shqyrtohet dhe këtë influencë në vendimin për lejen e zhvillimit. Duhet përfshirë sa më shumë informacion që të jetë e mundur në Kolonën 4 mbi shkallën e rëndësisë si një guidë / drejtim për studimet e planifikimit mjedisor.

Gjatë përdorimit të kësaj Liste kontrolli është e rëndësishme të mos harrohet se **efektet dytësore dhe të një rendi më të lartë** mund të ndodhin si rezultat i një **bashkëveprimi parësor** midis një aktiviteti të projektit dhe mjedisit të projektit. Kështu për shembull, një ndryshim në vërshimet në terren mund të prekë hidrologjinë e rrjedhës ujore; kjo gjë rrjedhimisht ndikon cilësinë e ujit dhe ekologjinë e rrjedhës ujore; dhe kjo më pas mund të ndikojë tek rritja e peshkut dhe përdorimet e tjera të ujit. Në rastet kur identifikohet një efekt parësor gjithmonë duhet marrë në konsideratë nëse si rezultat i tij mund të lindë një efekt dytësor apo mund të lindin efekte të mëtejshme në aspekte të tjera të mjedisit.

Gjithashtu duhet të mos harrohet se efektet mund të ndodhin jo vetëm **në mënyrë të përhershme** dhe gjatë periudhave afatgjata, por edhe **përkohësisht**, për shembull vetëm gjatë ndërtimit, instalimit / përdorimit të parë të impiantit ose çinstalimit / mbylljes së operacioneve ose vetëm gjatë fazave të caktuara të operimit të projektit, ose që mund të ndodhin vetëm **në mënyrë sporadike**, për shembull gjatë periudhave të caktuara kohore të aktivitetit ose kohëve të vitit ose **si rezultat i ngjarjeve jo normale** që ndikojnë projektin (aksidente, kushtet anormale të motit, tërmetet, etj.).

Ligji kërkon gjithashtu që Raporti i thelluar VNM të shqyrtojë efekte që mund të lindin në mënyrë **jo të drejtpërdrejtë** nga projekti, për shembull si rezultat i zhvillimeve të tjera që mund të ndodhin si rrjedhojë e projektit për shembull për të siguruar akses në furnizimin me uje apo energji, trajtimin e ujërave të zeza apo asgjësimin e mbetjeve, ose në shtëpi apo për të siguruar punë për njerëzit që tërhiqen në zonë nga projekti. Gjithashtu ai kërkon shqyrtimin e **efekteve të akumuluara** që mund të lindin nga kombinimi i efekteve të projektit me ato të zhvillimeve të tjera ekzistuese apo të planifikuara në zonën përreth.

Aneksi 2.A.2 Karakteristikat e Mjedisit të Projektit

Për çdo karakteristikë të projektit të identifikuar në Aneksin 2.A.1, duhet shqyrtuar nëse ndonjë nga komponentët rrjedhës të mjedisit mund të ndikohet.

Nr.	Pyetja	Po/Jo?
1	A ka karakteristika të mjedisit lokal në ose përreth vendodhjes së Projektit që mund të ndikohen nga Projekti?	
	Zona që janë të mbrojtura në bazë të legjislacionit ndërkombëtar ose kombëtar ose local për peisazhin e tyre, vlerat e tyre ekologjike, kulturore apo ndonjë vlerë tjetër, që mund të ndikohen nga projekti?	
	Zona të tjera që janë të rëndësishme apo të ndjeshme për arsye të ekologjisë së tyre, për arsye të ekologjisë së tyre, për shembull: <ul style="list-style-type: none"> • Ligatinat, • rrjedhat ujore apo trupat ujorë, • zonat bregdetare, • malet, • pyjet ose zonat me drurë (pemishtet) 	
	Zona që përdoren nga specie të mbrojtura, të rëndësishme apo të ndjeshme të florës ose faunës për shembull: për mbarështimin, krijimin e foleve, kërkimin për ushqimin, pushimin, (letargjinë) gjumin dimëror, migrimin, të cilat mund të ndikohen nga Projekti?	
	Ujëra në tokë, bregdetarë, marine apo nëntokësorë?	
	Zona apo karakteristika të peisazheve të larta apo vlerave skenike?	
	Rrugë apo lehtësira të përdorura nga publiku si hyrje për në qendrat e argëtimit apo lehtësira të tjera?	
	Rrugë transporti që janë të prirura për bllokim osë që shkaktojnë probleme mjedisore?	
	Zona ose karakteristika më rëndësi historike ose kulturore?	
2	A ndodhet Projekti në një zonë ku ka mundësi të jetë i dukshëm për shumë njerëz?	
3	A ndodhet Projekti në një zonë të pazhvilluar më parë ku do të ketë humbje të tokës së gjelbër?	
4	A ka përdorime të tokës ekzistuese në apo përreth vendodhjes së Projektit që mund të ndikohen nga Projekti? Për shembull: <ul style="list-style-type: none"> • shtëpitë, kopshtet, pronat e tjera private, • industria, • tregtia, • qendrat e argëtimit, • hapësirat e hapura publike, • lehtësirat e komunitetit, • bujqësia, • pylltaria, • turizmi, • minierat ose guroret 	
5	A ka plane për përdorim të ardhshëm të tokës në apo përreth vendodhjes që mund të ndikohet nga Projekti?	
6	A ka zona në apo përreth vendodhjes që janë dendësisht të populluara apo me shumë ndërtime, që mund të ndikohen nga Projekti?	

Nr.	Pyetja	Po/Jo?
7	<p>A ka zona në apo përreth vendodhjes që janë zënë nga përdorime të ndjeshme të tokës, që mund të ndikohen nga Projekti? upied by sensitive land uses ëhich could be affected by the Project?</p> <ul style="list-style-type: none"> • spitale, • shkolla, • faltore, • lehtësira për komunitetin 	
8	<p>A ka zona në apo përreth vendodhjes që përmbajnë burime të rëndësishme, me cilësi të lartë ose burime të rralla, që mund të ndikohen nga Projekti? Për shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> • burime tokësore, • ujëra sipërfaqësorë, • pylltari, • bujqësi, • rritja e peshkut, • turizmi, • mineralet. 	
9	<p>A ka zona në apo përreth vendodhjes që janë ndërkohë subjekt i ndotjes apo dëmeve mjedisore për shembull në rastet ku janë tejkalar standartet ekzistuese ligjore për mjedisin, që mund të ndikohen nga Projekti?</p>	
10	<p>A është vendodhja e Projektit e prirur ndaj tërmeteve, ekzistenës, shkarjet e tokës, erozioni, përmbytjet apo kushtet klimaterike ekstreme apo negative për shembull: ndryshimet e anasjellta të temperaturës, mjegulla, erërat e forta, që mund ta bëjnë projektin të shfaqë probleme mjedisore?</p>	
11	<p>A ka të ngjarë që Projekti të ndikojë kushtet fizike e ndonjë prej mjeteve të mjedisit?</p>	
	<p>Mjedisi atmosferik përfshirë kushtet mikroklimaterike dhe ato lokale apo të një shkalle më të madhe?</p>	
	<p>Uji – për shembull: sasi të, rrjedhat ose nivelet e lumenjve, liqeneve, ujërave tokësorë. Ujërat estuarë (lumorë), bregdetarë apo deti?</p>	
	<p>Toka - për shembull: sasi të, thellësitë, lagështira, qendrueshmëria ose prirja për erozion / gërryerje e tokës?</p>	
	<p>Kushtet gjeologjike dhe ato të tokës?</p>	
12	<p>A ka mundësi që çlirimet nga Projekti të kenë efekte në cilësinë e ndonjë prej mjeteve të mjedisit?</p>	
	<p>Cilësia e ajrit lokal?</p>	
	<p>Cilësia e ajrit global përfshirë ndryshimin e klimës dhe vrimën e ozonit?</p>	
	<p>Cilësia e ujit – lumenjtë, liqenet, ujërat tokësorë, estuarë (lumorë), bregdetarë apo deti?</p>	
	<p>Statusi ushqyes dhe trofikimi i ujërave?</p>	
	<p>Acidifikimi i tokave ose ujërave?</p>	
	<p>Dhërat?</p>	
	<p>Zhurmat?</p>	
	<p>Temperatura, drita ose rrezatimi elektromagnetik përfshirë interferencën elektrike?</p>	
	<p>Prodhueshmëria e sistemeve natyrore ose bujqësore?</p>	
13	<p>A ka të ngjarë Projekti të prekë disponueshmërinë ose pamjaftueshmërinë / rrallësinë e ndonjë burimi lokal ose global?</p>	
	<p>Karburantet me prejardhje nga fosilet?</p>	
	<p>Uji?</p>	

Nr.	Pyetja	Po/Jo?
	Mineralet dhe agregatet?	
	Druri?	
	Burimet të tjera të parinovueshme?	
	Capaciteti i infrastrukturës në zonë – uji, kanalizimet e ujërave të zeza, gjenerimi dhe transmetimi i energjisë, telekomunikacioni, rrugët për asgjësimin e mbetjeve, hekurudhat?	
14	A ka të ngjarë që Projekti të ndikojë në shëndetin e njeriut apo mirëqenien e komunitetit?	
	Cilësia e toksicitetit të ajrit, ujit, produkteve ushqimore dhe produkteve të tjera që konsumohen nga njerëzit?	
	Sëmundshmëria ose vdekshmëria e individëve, komuniteteve apo popullatave nga ekspozimi ndaj ndotjes?	
	Ngjarja ose shpërndarja e vektorëve të sëmundjeve përfshirë insektet?	
	Prirshmëria (ekspozimi) i individëve, komuniteteve ose popullatave ndaj sëmundjeve?	
	Sensi i individëve për sigurinë personale?	
	Kohezioni dhe identiteti i komunitetit?	
	Identiteti dhe lidhjet kulturore?	
	Të drejtat e minoritetit?	
	Kushtet e strehimit?	
	Punësimi dhe cilësia e punësimit?	
	Kushtet ekonomike?	
	Institucionet sociale?	

Aneks 2.B Lista e Kontrollit të Krieteve për Vlerësimin e Rëndësisë së Efekteve në Mjedis

Kjo listë kontrolli ndihmon të përcaktohet nëse një ndikim ka mundësi të jetë i rëndësishëm apo jo. Kjo listë kontrolli duhet të përdoret bashkë me listën e kontrollit për raportin e thelluar të VNM (Aneksi 2.A). Lista e kontrollit për raportin e thelluar të VNM ndihmon të identifikohen rastet ku ka potencial për bashkëveprime midis një projekti dhe mjedisit të tij. Kjo listë kontrolli është hartuar për të ndihmuar në vendimin nëse këto bashkëveprime – efekte – ka të ngjarë të jenë të rëndësishme.

Shpesh është e vështirë të përcaktohet çfarë është “i rëndësishëm” në ndonjë situatë të veçantë. Një kontroll i thjeshtë i dobishëm duhet bërë për të pyetur nëse efekti është i tillë që duhet shqyrtuar dhe ka influencë në vendim. Në fazat e hershme të projektit ka të ngjarë të ketë pak informacion mbi të cilin të bazohet ky vendim, por lista e mëposhtme e pyetjeve mund të jetë e dobishme.

Pyetjet që duhen bërë këtu janë të njëjta me ato tek Raporti paraprak i VNM, por tashmë, në fazën e Raportit të thelluar të VNM, është e rëndësishme që të jepet sa më shumë informacion që të jetë i mundur në shkaqet pse efekti konsiderohet të ketë gjasa të jetë i rëndësishëm, më tepër sesa një përgjigje e thjeshtë “po/jo”.

Nr.	Pyetja për t'u marrë në konsideratë	Po/Jo	Shpjegimi i përgjigjes
1	A do të ketë ndryshim të madh në kushtet e mjedisit?		
2	A do të jenë karakteristikat e reja jashtë balancës me mjedisin ekzistues?		
3	A do të jetë efekti i pazakontë në një zonë apo veçanërisht kompleks?		
4	A do të shtrihet efekti në një zonë të madhe?		
5	A do të ketë potencial për ndikim ndërkuftar?		
6	A do të preken shumë njerëz?		
7	A do të preken shumë receptorë të llojeve të tjera (fauna dhe flora, bizneset, lehtësirat)?		
8	A do të ndikohen karakteristikat apo burimet e rralla ose me vlerë?		
9	A ekziston risku që të shkelen standartet mjedisore?		
10	A ekziston risku që të ndikohen vendet, zonat e mbrojtura, karakteristikat?		
11	A ka probabilitet të lartë të ndodhë efekti?		
12	A do të vazhdojë efekti për një kohë të gjatë?		
13	A do të jetë efekti më tepër i përhershëm sesa i përkohshëm?		
14	A do të jetë ndikimi më tepër i vazhdueshëm sesa sporadik?		
15	Nëse është sporadik do të jetë më tepër i shpeshtë sesa i rrallë?		
16	A do të jetë ndikimi i pakthyesëm?		
17	A do të jetë e vështirë të shmanget,		

Nr.	Pyetja për t'u marrë në konsideratë	Po/Jo	Shpjegimi i përgjigjes
	pakësohet apo rregullohet apo kompensohet efekti?		

Aneksi 2.C Lista e Kontrollit e Alternativave Potenciale dhe Masave Lehtësuese

Një qëllim i Raportit të thelluar të VNm është identifikimi i alternativave dhe masave të lehtësuese që mund të jenë të përshtatshme për t'u shqyrtuar nga zhvilluesi në finalizimin e propozimeve të projektit.

Lista e mëposhtme e kontrollit jep shembuj të llojeve të alternativave dhe masave që mund të jenë të disponueshme dhe që mund të pakësojnë ndikimin e projektit në mjedis.

Ligji (dhe Direktiva) nuk kërkojnë nga zhvilluesi gjithmonë alternative, por kur vepron kështu, ai duhet të ofrojë një skicë të alternativave kryesore dhe të tregojë arsyet kryesore për zgjedhjen e tij, duke marrë parasysh efektet në mjedis.

Megjithatë, në përgjithësi konsiderohet si praktikë e mirë të shqyrtohet paksa nëse ka alternativa praktike për një projekt që duhet të merret në konsideratë.

Nëse shqyrtohet ndonjë alternativë Ligji kërkon që zhvilluesi t'i përshkruajë ato në Raportin e Thelluar VNM dhe të shpegojë arsyet e tyre për zgjedhjen e projektit të propozuar.

Llojet e alternativave dhe masat lehtësuese që duhen shqyrtuar

1. Masat për menaxhimin e kërkesës për mallra ose shërbime
2. Masat për konservimin ose pakësimin e humbjes së burimeve
3. Përqasje të ndryshme për të plotësuar kërkesën
4. Vendodhjet ose rrugët
5. Proçet ose teknologjitë
6. Metodatat e punës
7. Planet dhe skicat e terrenit
8. Projekti i strukturave
9. Llojet dhe burimet e materialeve
10. Specifikimet e produktit
11. Grafiku për ndërtimin, operimin dhe çinstalimin / mbylljen e operacioneve përfshirë çdo fazim të projektit
12. Datat e fillimit dhe mbarimit
13. Madhësia e terrenit ose implantit
14. Niveli i prodhimit
15. Përgjegjësitë për zbatim
16. Kontrollët për ndotjen
17. Marrëveshjet për asgjësimin e mbetjeve përfshirë riciklimin, rikuperimin, ripërdorimin dhe asgjësimin përfundimtar
18. Marrëveshjet për akses dhe rrugët e trafikut për dhe nga kantieri / terreni
19. Lehtësira ndihmëse
20. Metodatat dhe sistemet e menaxhimit
21. Përgjegjësitë dhe procedurat për menaxhimin mjedisor
22. Punësimi dhe trainimi i stafit
23. Monitorimi dhe planet e kontigjencës
24. Marrëveshjet për çinstalimin / mbylljen e operacioneve, restaurimi i terrenit dhe përdorimi i mëtejshëm

25. Të mos bësh gjë ose të bësh pak (minimum)

Aneksi 3. Lista e Kontrollit e Çështjeve që duhen shqyrtuar për t'u Përfshirë në një Raport të thelluar VNM

Kjo Listë kontrolli synon të përdoret si një udhërrëfyes për çështjet që duhen shqyrtuar gjatë përgatitjes së Raportit të Thelluar të VNM. Si e tillë, ajo mund të jetë e dobishme gjithashtu gjatë dhe në fund të procesit të raportit të thelluar të VNM.

Nuk ka mundësi që secili dhe çdo zë në këtë listë kontrolli të ketë lidhje me projektin: kjo është diçka që do të jetë vendosur në fazën e raportit të thelluar të VNM.

Efektet e një projekti në mjedis gjatë fazave të ndërtimit dhe instalimit / përdorimit të parë të impiantit duhet të shqyrtohen veçmas nga efektet që lindin kur projekti është operacional.

Në rastet kur jeta operationale e projektit pritet të jetë e kufizuar, efektet e çinstalimit / mbylljes së operationeve ose rehabilitimit/ bonifikimit të tokës duhen shqyrtuar veçmas gjithashtu.

Nr.	Subjekti	
1	Hyrje	
1.1	Emri dhe adresa e zhvilluesit	
1.2	Statusi juridik i zhvilluesit	
1.3	Statusi juridik i projektit të propozuar	
1.4	Adresa dhe vendodhja e projektit të propozuar	
1.5	Informacion mbi tipin e projektit	
1.6	Informacion mbi planin dhe madhësinë e projektit	
1.7	Emri i ekspertit (kryesor) që ka përgatitur Raportin e Thelluar të VNM	
1.8	Numri ose provë e Çertifikatës së VNM së ekspertit	
2	Informacion mbi përshkrimin e projektit	
2.1	Qëllimi dhe karakteristikat fizike të projektit, përfshirë hollësitë e marrëveshjeve të propozuara të aksesit dhe transportit dhe numrat që duhen vënë në përdorim dhe nga do të vijnë ata	
2.2	Kërkesat për përdorimin e tokës dhe karakteristika të tjera fizike të projektit:	
	a. gjatë ndërtimit;	
	b. kur është operacional;	
	c. pasi ka ndaluar përdorimi (në rastet ku është e përshtatshme).	
2.3	Proçeset e prodhimit dhe karakteristikat operationale të projektit:	
	a. lloji dhe sasia e lëndëve të para, energjia dhe burime të tjera të konsumuara;	

Nr.	Subjekti	
	b. mbetjet dhe shkarkimet sipas llojit, sasisë, përbërjes dhe fortësisë përfshirë:	
	i. shkarkimet në ujë;	
	ii. shkarkimet në ajër;	
	iii. zhurmat;	
	iv. dridhjet;	
	v. drita;	
	vi. nxehtësia;	
	vii. rrezatimi;	
	viii. depozitat / mbetjet në tokë e dhë;	
	ix. të tjera.	
3	Alternativat (atje ku duhet)	
3.1	Terrenet kryesore alternative të shqyrtuara dhe arsyet për zgjedhjen finale (atje ku duhet)	
3.2	Proçeset kryesore alternative të shqyrtuara dhe arsyet për zgjedhjen finale (atje ku duhet)	
4	Informacion mbi përshkrimin e terrenit dhe mjedisit të tij	
	<i>Karakteristika fizike</i>	
4.1	Popullsia – afërsia dhe numrat.	
4.2	Flora dhe fauna (përfshirë si habitatet ashtu edhe speciet) – në veçanti, speciet e mbrojtura dhe habitatet e tyre.	
4.3	Toka: cilësia bujqësore, gjeologjia dhe gjeomorfologjia.	
4.4	Uji: zonat / shtresat ujëmbajtëse, rrjedhat ujore, vija bregdetare, përfshirë llojin, sasinë, përbërjen dhe fortësinë e çdo shkarkimi ekzistues.	
4.5	Ajri: faktorët klimaterikë, cilësia e ajrit, etj.	
4.6	Trashëgimnia arkitektonike dhe historike, zonat arkeologjike dhe karakteristikat, dhe asetet e materialeve.	
4.7	Peisazhi dhe topografia.	
4.8	Përdorimet për qëndra argëtimi.	
4.9	Karakteristika të tjera mjedisore që kanë lidhje.	
	<i>Kuadri i politikave</i>	
4.10	Atje ku duhet, informacion mbi çdo gjë të shpallur ose të mbrojtur si:	
	i. Zonat veçanërisht të mbrojtura	
	ii. Zona të tjera të konservimit	
	iii. Parqet	
	iv. Zonat arkeologjike	
	v. Zonat historike;	
	vi. Zonat ujore të mbrojtura.	
4.11	Informacion mbi politikat përkatëse kombëtare	
4.12	Informacion mbi të gjitha programet ose planet përkatëse rajonale ose lokale (përfshirë ato të aprovuara ose draftet)	
4.13	Duhet bërë referencë, ku ka mundësi, për shpalljet ndërkombëtare (p.sh. sipas Konventës së Ramsarit, Konventës së Biodiversitetit)	
5	Vlerësimi i efekteve	
	Ky duhet të përfshijë efektet e projektit të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, dytësore, të akumuluar, afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të përhershme dhe të përkohshme, pozitive dhe negative.	
	<i>Efektet mbi qëniet njerëzore, ndërtesat dhe karakteristikat e</i>	

Nr.	Subjekti	
	<i>ndërtuara nga njeriu</i>	
5.1	Ndryshimet në popullsi si pasojë e projektit dhe efektet rezultante në mjedis.	
5.2	Efekte pamore të projektit në zonën rrethuese dhe peisazhi.	
5.3	Nivelet dhe efektet e shkarkimeve nga projekti gjatë operimit normal.	
5.4	Nivelet dhe efektet e zhurmave nga projekti.	
5.5	Efektet e projektit në rrugët lokale dhe transport.	
5.6	Efektet e projektit në ndërtesa, trashëgiminë arkitektonike dhe historike, karakteristikat arkeologjike, dhe produkte të tjera të krijuara nga njeriu, p.sh.nëpërmjet ndotësve, ndërhyrjeve pamore dhe dridhjeve.	
	<i>Efektet tek flora, fauna dhe gjeologjia</i>	
5.7	Humbja e dhe dëmtimi i habitateve dhe specieve të bimëve dhe kafshëve.	
5.8	Humbja e dhe dëmtimi i karakteristikave gjeologjike, paleontologjike dhe fiziografike.	
5.9	Pasoja të tjera ekologjike.	
	<i>Efektet në tokë</i>	
5.10	Efektet fizike të zhvillimit, p.sh.ndryshimet në topografinë locale, efektet e lëvizjes së tokës ndaj qëndrueshmërisë, erozioni i tokës, etj.	
5.11	Efektet e shkarkimeve kimike dhe depozitat në tokën e terrenit/kantierit dhe atë përreth.	
5.12	Përdorimi i tokës/efektet e burimeve:	
	i. cilësia dhe sasia e tokës bujqësore që duhet marrë;	
	ii. efektet në burimet minerale;	
	iii. efektet në përdorimin e tokës përreth përfshirë bujqësinë;	
	iv. asgjësimi i mbetjeve;	
	v. përdorime të tjera alternative të terrenit përfshirë opsionin 'mos bëj asgjë';	
	<i>Efektet në ujë</i>	
5.13	Efektet e projektit në modelin e kullimit në zonë.	
5.14	Ndryshimet e karakteristikave të tjera hidrografike, p.sh. niveli i ujrave tokësorë, rrjedha ujore, rrjedha e ujrave nëntokësorë.	
5.15	Efektet në hidrologjinë bregdetare ose lumore.	
5.16	Efektet e ndotësve, mbetjeve, etj. në cilësinë e ujit.	
	<i>Efektet në ajër dhe klimë</i>	
5.17	Niveli dhe përqëndrimi i shkarkimeve kimike dhe efektet e tyre në mjedis.	
5.18	Çështje të veçanta.	
5.19	Erëra të pakëndshme.	
5.20	Efekte të tjera klimaterike.	
	<i>Efekte të tjera jo të drejtpërdrejta dhe dytësore të lidhura me projektin</i>	
5.21	Efektet nga trafiku (rrugor, hekurudhor, ajror, ujor) që lidhen me projektin.	
5.22	Efektet që lindin nga nxjerrja dhe konsumimi i materialeve, ujit, energjisë ose burimeve të tjera nga projekti.	
5.23	Efektet e zhvillimeve të tjera lidhur me projektin, p.sh.rrugët e reja, kanalet e ujërave të zeza, linjat e korrentit, tubacionet, telekomunikacioni, etj.	
5.24	Efektet e lidhjes së projektit me zhvillime të tjera ekzistuese ose të propozuara.	
5.25	Efektet dytësore që rezultojnë nga bashkëveprimi i efekteve të	

Nr.	Subjekti	
	drejtpërdrejta të renditura më sipër.	
6	Masat lehtësuese	
6.1	Në rastet kur identifikohen efekte negative të rëndësishme, përshkrimi i masave që duhen marrë për të shmangur, pakësuar ose përmirësuar/kuruar këto efekte, p.sh.:	
	i. planifikimi i terrenit;	
	ii. masat teknike, p.sh.:	
	a. përzgjedhja e procesit;	
	b. riciklimit;	
	c. kontrolli i ndotjes dhe trajtimi;	
	d. kufizimi (p.sh. kufizimi i enëve/kontenierëve magazinuese).	
	iii. masat estetike dhe ekologjike, p.sh.:	
	a. formimi i pirqjeve të dhéut;	
	b. plani, ngjyra, etj.;	
	c. peisazhi;	
	d. mbjellja e pemëve;	
	e. masat për të ruajtur habitate të vecanta ose për të krijuar habitate alternative;	
	f. regjistrimi i zonave arkeologjike;	
	g. masat për të ruajtur zonat ose ndërtesat historike.	
6.2	Një vlerësim i efektivitetit të mundshëm të masave lehtësuese.	
7	Risku i aksidenteve dhe projekteve të rrezikshme	
7.1	Kur projekti i propozuar përshin materiale që mund të jenë të dëmshme për mjedisin (përfshirë njerëzit) në rast aksidenti, Raporti i Thelluar i VNM duhet të përfshijë tregimin e masave parandaluese që do të merren në mënyrë që një ngjarje e tillë të mos ketë gjasa të ketë efekt të rëndësishëm. Kjo mund, aty ku është e përshtatshme, të përfshijë referencë për përmbushjen / respektimin e legjislacionit për shëndetin dhe sigurinë.	
7.2	Kur projekti i propozuar synon të mbajë ose përdorë substanca të rrezikshme, Raporti i Thelluar i VNM duhet të përfshijë informacion për vlerësimin e duhur të riskut.	
8	Kompensimi ose zëvendësimi	
	Në rast shkeljeje përparësore në natyrë dhe peisazh, Raporti i Thelluar i VNM duhet të përmbajë hollësi të masave që duhen marrë për kompensimin ose zëvendësimin.	
9	Vështirësitë	
	Raporti i Thelluar i VNM duhet të tregojë të gjitha defiçencat teknike ose mungesat e njohurive që janë ndeshur në hartimin e tij	
10	Përmbledhja Jo teknike	

Aneksi 4. Rishikim i Listës së Kontrollit për Raportin³ e Thelluar të VNM

Kjo Listë kontrolli është hartuar për të ndihmuar autoritetet (sidomos Ministrinë) në rishikimin e cilësisë së Raportit të Thelluar të VNM për të kontrolluar mjaftueshmërinë e tij për vendimarrje dhe konsultim.

Për këtë arsye, ai mund të jetë i dobishëm për zhvilluesin në përgatitjen e Raportit si një kontroll për të siguruar që informacioni i dhënë në Raport të mund të jetë i mjaftueshëm.

Lista e kontrollit është organizuar në shtatë seksione:

1. Përshkrimi i projektit
2. Alternativat
3. Përshkrimi i mjedisit që ka gjasa të ndikohen nga projekti
4. Përshkrimi i efekteve të mundshme të rëndësishme të projektit
5. Përshkrimi i Masave Lehtësuese
6. Përmbledhja Jo teknike
7. Cilësia e prezantimit

Ekzistojnë një sërë pyetjesh që kërkojnë përgjigje brenda çdo seksioni.

Në fund të çdo seksioni të listës së kontrollit do të jetë e nevojshme të shqyrtohet nëse ka ndonjë pyetje shtesë që duhet shtuar në atë seksion, për shkak të ndonjë karakteristike të veçantë të projektit që nënkupton se disa lloje informacioni që kanë lidhje nuk janë marrë ende në konsideratë.

Udhëzime për përdorim

1. Së pari vendosni për çdo pyetje, nëse ajo ka lidhje me projektin specifik. Nëse ka, përgjigjuni “po” në kolonën 2. Nëse nuk ka, përgjigjuni “jo”.
2. Nëse identifikohet që pyetja ka lidhje, atëherë do të jetë e nevojshme të rishikohet Raporti i Thelluar i VNM me më shumë hollësi me qëllim që të vendosë nëse (për atë pyetje) informacioni i dhënë është i mjaftueshëm për vendimarrje. Nëse është kështu, përgjigjuni “po” në kolonën 3. Nëse nuk është kështu, përgjigjuni “jo”.
3. Kur shqyrtohet nëse informacioni është i mjaftueshëm për vendimarrje, mund të jetë e nevojshme që të merret në konsideratë nëse ka ndonjë boshllëk apo mungesë informacioni; dhe nëse ato boshllëqe apo mungesa janë thelbësor për procesin e vendimarrjes. Nëse nuk janë thelbësor, atëherë mund të mos jetë e nevojshme që të kërkohet informacion shtesë për atë çështje (kjo mund të shmangë vonesën e

³ Këto Lista kontrolli janë marrë nga Udhërrëfytyesi i Komunitetit Evropian për VNM, Rishikimi i DNM, Qershor 2001

panevojshme në proçes). Faktorët që mund të nevojiten të merren në konsideratë këtu përfshijnë:

- a. Kërkesat ligjore të Ligjit: a është ky informacion diçka që “duhet” të jepet, ose “mund” të jepet nëse ka lidhje me projektin
 - b. Shkalla dhe kompleksiteti i projektit
 - c. Ndjeshmëria e mjedisit pritës
 - d. Pikëpamjet e publikut dhe autoriteteve të tjera të konsultuara rreth projektit
 - e. Çdo nivel mosmarrëveshjeje / debate rreth projektit.
4. Nëse përgjigja ishte “jo”, atëherë do të ishte e nevojshme të shqyrtohej se çfarë informacioni shtesë do të kërkohet. Kjo duhet dokumentuar në kolonën 4. Gjithashtu mund të jetë e dobishme në këtë fazë që këtu të shënohet çdo sugjerim për mënyrën se si ose ku zhvilluesi mund të gjejë ose përftojë informacion.

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
1. Përshkrimi i projektit				
<i>Objektivat dhe karakteristikat fizike të projektit</i>				
1.1	A është shpjeguar nevoja për projektin?			
1.2	A janë shpjeguar objektivat e projektit?			
1.3	A është përshkruar programi për zbatim i projektit, duke dhënë hollësi për kohëzgjatjen e parashikuar, datën e fillimit dhe të përfundimit për ndërtimin, operimin dhe çinstalimin / mbylljen e operacioneve? (Kjo duhet të përfshijë edhe ndonjë fazë të aktivitetit të ndryshëm nga fazat kryesore të projektit, për shembull fazat e nxjerrjes në punimet në miniera)			
1.4	A janë përshkruar përberësit kryesorë të projektit? (Shikoni Aneksin 2.A.1 Lista e kontrollit për raportin e thelluar të VNM të Karakteristikave të Projektit)			
1.5	A është e identifikuar vendndodhja e çdo përbërësi të projektit, duke përdorur harta, plane dhe diagrama sipas nevojave?			
1.6	A është përshkruar planifikimi i territorit (ose territoreve) të zënë nga projekti?			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	(Kjo duhet të përfshijë, sipas nevojave katet përdhese, ndërtesat, struktura të tjera fizike, punimet nëntokësore, punimet bregdetare, impiantet e magazinimit, karakteristikat e ujit, mbjellja, korridoret hyrëse, kufijtë)			
1.7	A janë përshkruar korridoret rrugore, pozicionimi vertikal dhe horizontal dhe punimet me dhë apo për ndëtimin e tuneleve për projektet lineare?			
1.8	A janë përshkruar të gjitha aktivitetet e përfshira në ndëtimin e projektit?			
1.9	A janë përshkruar të gjitha aktivitetet e përfshira në operimin e projektit?			
1.10	A janë përshkruar të gjitha aktivitetet e përfshira në çinstalimin / mbylljen e operacioneve të projektit? (Kjo duhet të përfshijë sipas nevojave, mbylljen, çmontimin, prishjen, pastrimin, restaurimin e territorit, ripërdorimin e territorit, etj)			
1.11	A janë përshkruar të gjitha shërbimet shtesë të kërkuara për projektin? (p.sh. aksesit në transport, ujë, ujrat e zeza, asgjësimi i mbetjeve, energjia elektrike, telekomunikimi)			
1.12	A janë përshkruar të gjitha zhvillime shtesë që kërkohen për projektin? (p.sh. rrugët, portet, linjat e rrymës elektrike, tubacionet)			
1.13	A është identifikuar ndonjë zhvillim që ka mundësi të ndodhë si pasojë e projektit? (p.sh. ndërtimi i shtëpive të reja, rrugët, infrastruktura e ujit ose e ujrave të zeza, nxjerrja e agregateve)			
1.14	A është identifikuar ndonjë nga aktivitetet ekzistuese i cili			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	mund të alternohet ose ndalohet si pasojë e projektit?			
1.15	A është identifikuar ndonjë zhvillim ekzistues ose i planifikuar me të cilin projekti mund të ketë efekt të akumuluar?			
<i>Madhësia e projektit</i>				
1.16	A është zona e tokës e zënë nga secili prej komponentëve të përhershëm të projektit të llogaritur dhe treguar në një hartë të shkallëzuar? (përfshirë të gjitha marrëveshjet që kanë lidhje me aksesin në peisazhe dhe lehtësira ndihmëse)			
1.17	A është llogaritur dhe hartëzuar zona e tokës që kërkohet përkohësisht për ndërtim?			
1.18	A është përshkruar bonifikimi/rehabilitimi dhe përdorimi i mëtejshëm i tokës së zënë përkohësisht për operim? (p.sh. toka e përdorur për minierat ose guroret)			
1.19	A janë identifikuar përmasat e ndonjë strukture ose punëve të tjera të zhvilluara si pjesë e projektit? (p.sh. sipërfaqja e katit dhe lartësia e ndërtesave, përmasat e gërmimit, sipërfaqja ose lartësia e bimëve të mbjella, lartësia e strukturave siç janë pritrat, urat ose oxhaqet, rrjedha ose thellësia e ujit)			
1.20	A është përshkruar forma dhe paraqitja e strukturave ose punëve të tjera të zhvilluara si pjesë e projektit? (p.sh. lloji, përfundimi dhe ngjyra e materialeve, dizenjimi arkitektonik i ndërtesave dhe strukturave, speciet bimore, sipërfaqet tokësore, etj)			
1.21	A janë përshkruar numrat dhe			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	karakteristikat e popullatave të reja ose komuniteteve biznesit për projektet për zhvillim urban apo zhvillime të ngjashme?			
1.22	A janë përshkruar për projektet që përfshijnë zhvendosjen e njerëzve dhe bizneseve, numrat dhe karakteristikat e këtyre zhvendosjeve?			
1.23	A janë përshkruar projektet e infrastrukturës së re të transportit apo projektet që gjenerojnë rrjedha të konsiderueshme trafiku, lloji, vëllimi, modeli i përkohshëm dhe shpërndarja gjeografike e trafikut të ri të gjeneruar ose ndryshuar si rrjedhim i projektit?			
<i>Proçesi i prodhimit dhe burimet e përdorura</i>				
1.24	A janë përshkruar të gjitha proçeset e përfshira në operimin e projektit? (p.sh. proçeset e manifakturimit ose të projekteve, prodhimi i materialeve të lëndëve të para, metodat e prodhimit agrikulturor ose pyjor, proçeset e nxjerrjes)			
1.25	A janë përshkruar llojet dhe sasi të produktit të prodhuara nga projektit? (këto duhet të jenë produkte parësore ose të manualluara, të mira materiale, siç janë energjia, furnizimi me ujë ose shërbime, siç janë shtëpitë, transporti, shitjet me pakicë, qendrat e argëtimit, arsimit, shërbimet bashkiake (uji, mbetjet, etj.)			
1.26	A janë diskutuar llojet dhe sasi të materialeve të lëndëve të para dhe energjia që duhet për ndërtim?			
1.27	A janë diskutuar llojet dhe sasi të materialeve të lëndëve të para dhe energjia që duhet për operim?			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
1.28	A janë diskutuar implikimet në mjedis të gjetjes së burimeve të lëndëve të para?			
1.28	A është diskutuar efienca në përdorimin e energjisë dhe lëndëve të para?			
1.29	A janë identifikuar dhe llogaritur sasi të materialeve të rrezikshme të përdorura, magazinuara, dorëzuara ose prodhuara nga projekti gjatë ndërtimit?			
1.30	A janë identifikuar dhe llogaritur sasi të materialeve të rrezikshme të përdorura, magazinuara, dorëzuara ose prodhuara nga projekti gjatë operimit?			
	A janë identifikuar dhe llogaritur sasi të materialeve të rrezikshme të përdorura, magazinuara, dorëzuara ose prodhuara nga projektin gjatë instalimit / mbylljes së operacioneve?			
1.31	A është diskutuar mbi transportin (p.sh. rrugor, hekurudhor ose detar) e lëndëve të para për tek projekti dhe numrin e lëvizjeve të trafikut të përfshirë – gjatë ndërtimit ?			
1.32	A është diskutuar mbi transportin (p.sh. rrugor, hekurudhor ose detar) e lëndëve të para për tek projekti dhe numrin e lëvizjeve të trafikut të përfshirë – gjatë operimit ?			
1.33	A është diskutuar mbi transportin (p.sh. rrugor, hekurudhor ose detar) e lëndëve të para për tek projekti dhe numrin e lëvizjeve të trafikut të përfshirë – gjatë instalimit / mbylljes së operacioneve?			
1.34	A është diskutuar mbi krijimin apo humbjen apo humbjen e			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	vendeve të punës si rezultat i projektit gjatë ndërtimit?			
1.35	A është diskutuar mbi krijimin apo humbjen apo humbjen e vendeve të punës si rezultat i projektit gjatë operimit?			
1.36	A është diskutuar mbi krijimin apo humbjen apo humbjen e vendeve të punës si rezultat i projektit gjatë çinstalimit / mbylljes së operacioneve?			
1.37	A janë vlerësuar marrëveshjet e për akses dhe numri i lëvizjeve të trafikut të përfshirë në transportin e punëtorëve dhe vizitorëve në projekt gjatë ndërtimit?			
1.38	A janë vlerësuar marrëveshjet e për akses dhe numri i lëvizjeve të trafikut të përfshirë në transportin e punëtorëve dhe vizitorëve në projekt gjatë operimit?			
1.39	A janë vlerësuar marrëveshjet e për akses dhe numri i lëvizjeve të trafikut të përfshirë në transportin e punëtorëve dhe vizitorëve në projekt gjatë çinstalimit / mbylljes së operacioneve?			
1.40	A është diskutuar strehimi dhe ofrimi i shërbimeve për punonjësit e përhershëm ose të përkohshëm të projektit? (ka lidhje vetëm me projektet që kërkojnë migrimin e forcës së re të punës në zonë ose për ndërtim ose për periudhë afatgjatë.			
<i>Rezinat dhe shkarkimet</i>				
1.41	A janë identifikuar llojet dhe sasi të mbetjeve të ngurta të gjeneruara nga projekti gjatë ndërtimit?			
1.42	A janë identifikuar llojet dhe sasi të mbetjeve të ngurta të gjeneruara nga projekti gjatë operimit?			
1.43	A janë identifikuar llojet dhe			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	sasitë e mbetjeve të ngurta të gjeneruara nga projekti gjatë çinstalimit / mbylljes së operacioneve?			
1.44	A është diskutuar për përbërjen dhe toksicitetin ose rreziqe të tjera të të gjithë mbetjeve të ngurta të prodhuara nga projekti?			
1.45	A janë përshkruar metodat pr grumbullimin, magazinimin, trajtimin, transportimin dhe së fundmi asgjesimin e këtyre mbetjeve të ngurta?			
1.46	A është diskutuar për vendodhjen e asgjesimit përfundimtar të të gjitha mbetjeve të ngurta?			
1.47	A janë identifikuar llojet dhe sasitë e mbetjeve të lëngshme të gjeneruara nga projekti gjatë ndërtimit?			
1.48	A janë identifikuar llojet dhe sasitë e mbetjeve të lëngshme të gjeneruara nga projekti gjatë operimit?			
1.49	A janë identifikuar llojet dhe sasitë e mbetjeve të lëngshme të gjeneruara nga projekti gjatë çinstalimit / mbylljes së operacioneve?			
1.50	A është diskutuar për përbërjen dhe toksicitetin ose rreziqe të tjera të të gjithë mbetjeve të lëngshme të prodhuara nga projekti?			
1.51	A janë përshkruar metodat pr grumbullimin, magazinimin, trajtimin, transportimin dhe së fundmi asgjesimin e këtyre mbetjeve të lëngshme?			
1.52	A janë identifikuar vendodhjet për shkarkimin e të gjitha shkarkimeve në ujërat sipërfaqësore dhe a janë identifikuar karakteristikat e shkarkimeve? (p.sh. gjatësia e tubacionit me rrjedhje nga brenda jashtë, shpejtësia dhe			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	temperature e çlirimit)			
1.53	A është diskutuar për vendodhjen e asgjesimit përfundimtar të të gjitha mbetjeve të lëngshme?			
1.54	A janë identifikuar llojet dhe sasi të shkarkimeve të gazta dhe thërrmijave të gjeneruara nga projekti gjatë ndërtimit?			
1.55	A janë identifikuar llojet dhe sasi të shkarkimeve të gazta dhe thërrmijave të gjeneruara nga projekti gjatë operimit?			
1.56	A janë identifikuar llojet dhe sasi të shkarkimeve të gazta dhe thërrmijave të gjeneruara nga projekti gjatë instalimit / mbylljes së operacioneve?			
1.57	A është diskutuar për përbërjen dhe toksicitetin ose rreziqe të tjera të të gjitha shkarkimeve në ajër të prodhuara nga projekti?			
1.58	A janë përshkruar metodat për grumbullimin, magazinimin, trajtimin, dhe së fundmi shkarkimin e këtyre shkarkimeve në ajër?			
1.59	A janë identifikuar vendodhjet për shkarkimin e të gjitha shkarkimeve në ajër dhe a janë identifikuar karakteristikat e shkarkimeve? (p.sh. lartësia e oxhakut, shpejtësia dhe temperature e çlirimit)			
1.60	A është diskutuar mbi potencialin për rikuperimin e burimeve nga mbetjet dhe rezinat? (përfshirë ripërdorimin, riciklimin ose rikuperimin e energjisë nga mbetjet e ngurta dhe mbetjet e lëngshme)			
1.61	A janë identifikuar dhe llogaritur burimet e zhurmave, nxehtësisë, dritës ose rrezatimit elektromagnetik nga projekti?			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	(përfshirë paisjet, proceset, punimet e ndërtimit, trafikun, ndriçimin, etj.)			
1.62	A janë identifikuar metodat për vlerësimin e sasive dhe përbërjen e të gjitha rezinave dhe shkarkimeve dhe a është diskutuar për ndonjë vështirësi?			
1.63	A është diskutuar për pasigurinë e lidhur me vlerësimet e rezinave dhe shkarkimeve?			
<i>Risqet e aksidenteve dhe rreziqet</i>				
1.64	A është diskutuar për ndonjë risk në lidhje me projektin:			
	a. risqet nga dorëzimi i materialeve të rrezikshme			
	b. risqet nga derdhjet, zjarri, shpërthimi			
	c. risqet nga aksidentet e trafikut			
	d. risqet nga ndarja ose mosfunksionimi i proceseve ose impianteve			
	e. risqet nga ekspozimi i projektit ndaj fatkeqësive natyrore			
1.65	A janë përshkruar masat për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur aksidenteve dhe ngjarjeve anormale? (p.sh. masat parandaluese, trainimi, planet e kontigjencës, planet e urgjencës, etj.)			
<i>Pyetje tjera mbi Përshkrimin e projektit</i>				
2. Shqyrtimi i alternativave				
2.1	A janë përshkruar alternativat që janë shqyrtuar?			
2.2	A është përshkruar situata bazë fillestare në rastin e Asnjë Projekti?			
2.3	A janë alternativat e projektit realiste dhe të sigerta?			
2.4	A janë shpjeguar arsyet kryesore për zgjedhjen e			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	projektit përfshirë të gjitha arsyet mjedisore për zgjedhjen?			
2.5	A janë krahasuar efektet kryesore në mjedis të alternativave me ato të projektit?			
<i>Pyetje të tjera për Shqyrtimin e alternativave</i>				
3. Aspektet e mjedisit				
3.1	A janë përshkruar përdorimet e tokës ekzistuese për tokën që do të zihet nga projekti dhe zonat përreth dhe a jetojnë njerëz në apo përdorin tokën e identifikuar? (përfshirë përdorimet e tokës rezidenciale, tregtare, industriale, bujqësore, për qëllime argëtimi dhe komoditeti dhe çdo ndërtesë, strukturë apo pronë tjetër)			
3.2	A janë përshkruar topografia, gjeologjia dhe dhërat e tokës që do të zihet nga projekti dhe zonat përreth?			
3.3	A janë përshkruar karakteristikat e rëndësishme të topografisë ose gjeologjisë së zonës dhe a janë përshkruar kushtet dhe përdorimi i tokave? (përfshirë qëndrueshmërinë e cilësisë së tokës dhe erozionin, përdorimin bujqësor dhe cilësinë e tokës bujqësore)			
3.4	A janë përshkruar dhe ilustruar në harta të përshtatshme fauna dhe flora dhe habitatet e tokës që do të zihet nga projekti dhe zonat përreth?			
3.5	A janë përshkruar popullatat e specieve dhe karakteristikat e habitateve që mund të ndikohen nga projekti dhe a ka ndonjë specie të shpallur apo të mbrojtur apo ndonjë zonë të përcaktuar?			
3.6	A është përshkruar mjedisi ujor			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	i zonës – nëse mjedisi ujqor mund të ndikohet nga projekti? (përfshirë ujërat sipërfaqësore që rrjedhin dhe ato statike, ujërat tokësore, estuarët, ujërat bregdetarë dhe detin dhe përfshirë derdhjet / vërshimet dhe kullimet.			
3.7	A janë përshkruar hidrologjia, cilësia e ujit dhe përdorimi i të gjithë burimeve ujore që mund të ndikohen nga projekti? (përfshirë përdorimin e furnizimit me ujë, rritjen e peshkut, peshkimin me grep, ujërat që përdoren për banjë / për t'u larë, komoditetin, lundrimin, asgjesimin e mbetjeve të lëngshme)			
3.8	A janë përshkruar kushtet lokale klimaterike dhe meteorologjike dhe cilësia e ajrit ekzistues në zonë nëse cilësia e ajrit mund të ndikohet nga projekti?			
3.9	A është përshkruar klima ekzituese e zhurmave – nëse mjedisi akustik mund të ndikohet nga projekti?			
3.10	A është përshkruar situata ekzistuese në lidhje me dritën, nxehtësinë dhe rrezatimin elektromagnetik – nëse këto aspekte të mjedisit mund të ndikohen nga projekti?			
3.11	A janë përshkruar asetet material në zonë që mund të ndikohen nga projekti? (përfshirë ndërtesat, strukturat e tjera, burimet minerale, burimet ujore, etj.)			
3.12	A janë përshkruar vendodhjet ose karakteristikat me rëndësi arkeologjike, historike, kulturore ose të komuniteteve të tjera në zonë që mund të ndikohen nga projekti, përfshirë zonat e shpallura ose të mbrojtura?			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
3.13	A është përshkruar peisazhi i tokës apo qytetit në zonën që mund të ndikohet nga projekti, përfshirë të gjitha peisazhet e shpallura apo të mbrojtura dhe të gjithat pamjet apo pikat e pamjes të rëndësishme?			
3.14	A janë përshkruar kushtet demografike, sociale dhe socio-ekonomike (p.sh. punësimi) në zonë?			
3.15	A janë përshkruar ndryshimet e ardhshme në ndonjërin prej aspekteve të mësipërm të mjedisit, që mund të ndodhin në mungesë të projektit? (që do të thotë 'situata me asnjë projekt)			
<i>Mbledhja e të dhënave dhe metodat e anketimit</i>				
3.16	A është përcaktuar zona e studimit mjaft gjerë për të përfshirë të gjithë zonën që ka gjasa të ndikohet konsiderueshëm nga projekti?			
3.17	A janë kontaktuar të gjitha institucionet kombëtare dhe lokale për të mbledhur informacionin në mjedisin bazë fillestar?			
3.18	A u është bërë referenca e duhur burimeve të të dhënave dhe informacionit në mjedisin ekzistues?			
3.19	Në rastet ku janë ndërmarrë anketime si pjesë e Studimeve Mjedisore për të karakterizuar mjedisin bazë fillestar, a janë përshkruar metodat e përdorura, vështirësitë e hasura dhe pasiguritë për të dhënat?			
3.20	A janë metodat e përdorura të përshtatshme për përdorim?			
3.21	A janë identifikuar boshllëqet e rëndësishme tek të dhënat për mjedisin ekzistues dhe a janë shpjeguar mjetet e përdorura për t'u marrë me këto boshllëqe gjatë vlerësimit?			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
3.22	Nëse do të kërkoheshin anketime për të karakterizuar në mënyrën e duhur mjedisin bazë fillestar, por ato nuk kanë qenë të praktikueshme për ndonjë arsye, a janë shpjeguar arsyet dhe përcaktuar propozimet për anketimet që duhen ndërmarrë në një fazë të mëvonshme?			
<i>Pyetje të tjera për Përshkrimin e Mjedisit</i>				
4. Përshkrimi i efekteve të mundshme të rëndësishme të projektit				
<i>Përcaktimi i objektit / gamës së efekteve</i>				
4.1	A është përshkruar procesi me anë të të cilit është përcaktuar objekti / gama e Raportit të thelluar të VNM? (Shih Aneksin 2 për raportin e thelluar të VNM)			
4.2	Në rastet kur Ministria ka dhënë mendim paraprak për raportin e thelluar të VNM, a është ndjekur?			
4.3	A është e dukshme që është adoptuar një përqasje sistematike për raportin e thelluar të VNM?			
4.4	Nëse ka patur konsultime gjatë përgatitjes së raportit të thelluar të VNM, a është përshkruar kjo gjë?			
4.5	Nëse ka patur konsultime gjatë përgatitjes së raportit të thelluar të VNM, a janë prezantuar komentet që kanë rezultuar nga konsultimi?			
<i>Parashikimi i efekteve të drejtpërdrejta</i>				
4.6	A janë përshkruar efektet parësore të drejtpërdrejta mbi përdorimet e tokës, njerëzit dhe pronat dhe a janë llogaritur aty ku është e përshtatshme?			
4.7	A janë përshkruar efektet parësore të drejtpërdrejta mbi tiparet gjeologjike dhe karakteristikat e tokës dhe a			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	janë llogaritur aty ku është e përshtatshme?			
4.8	A janë përshkruar efektet parësore të drejtpërdrejta mbi faunën dhe florën dhe habitatet dhe a janë llogaritur aty ku është e përshtatshme?			
4.9	A janë përshkruar efektet parësore të drejtpërdrejta mbi mbi hidrologjinë dhe cilësinë e ujit të tipareve të ujit dhe a janë llogaritur aty ku është e përshtatshme?			
4.10	A janë përshkruar efektet parësore të drejtpërdrejta mbi përdorimet e mjedisit ujor dhe a janë llogaritur aty ku është e përshtatshme?			
4.11	A janë përshkruar efektet parësore të drejtpërdrejta mbi cilësinë e ajrit dhe kushtet klimaterike dhe a janë llogaritur aty ku është e përshtatshme?			
4.12	A janë përshkruar efektet parësore të drejtpërdrejta mbi mjedisin akustik (zhurmat dhe dridhjet), dhe a janë llogaritur aty ku është e përshtatshme?			
4.13	A janë përshkruar efektet parësore të drejtpërdrejta mbi nxehtësinë, dritën ose rrezatimin elektromagnetik dhe a janë llogaritur aty ku është e përshtatshme?			
4.14	A janë përshkruar efektet parësore të drejtpërdrejta mbi asetet material dhe reduktimin e burimeve natyrore të parinovueshme (p.sh. karburantet nga fosilet, mineralet)?			
4.15	A janë përshkruar efektet parësore të drejtpërdrejta mbi vendodhjet apo karakteristikat me rëndësi kulturore?			
4.16	A janë përshkruar efektet parësore të drejtpërdrejta mbi cilësinë e peisazhit dhe pamjet			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	e pikëpamjet dhe a janë ilustruar aty ku është e përshtatshme?			
4.17	A janë përshkruar efektet parësore të drejtpërdrejta mbi demografinë, kushtet sociale dhe socio-ekonomike në zonë dhe a janë llogaritur aty ku është e përshtatshme?			
<i>Parashikimi i efekteve jo të drejtpërdrejta, dytësore, të akumuluarra, afatshkurtra, afatmesme, afatgjata, të përhershme, të përkohshme.</i>				
4.18	A janë përshkruar efektet jo të drejtpërdrejta në mjedis të shkaktuara nga zhvillimi rezultant? (zhvillim rezultues nënkupton projekte të tjera, që nuk janë pjesë e projektit kryesor, të stimuluarra të ndodhin nga zbatimi i projektit p.sh. për të ofruara mallra apo shërbime të reja të nevojshme për projektin, për të strehuar popullsi të reja apo biznese të stimuluarra nga projekti).			
4.19	A janë përshkruar efektet dytësore në ndonjë nga aspektet e mësipërme të mjedisit të shkaktuara nga efektet parësore në aspekte të tjera dhe a janë llogaritur aty ku është e përshtatshme? (p.sh. efektet tek fauna, habitatet e florës, shkaktuar nga ndotja e tokës, ajrit ose ujit apo zhurmat; efektet mbi përdorimet e ujit shkaktuar nga ndryshimet në hidrologji ose cilësinë e ujit, efektet në rrënojat arkeologjike shkaktuar nga dehidratimi i tokës)			
4.20	A janë përshkruar efektet e akumuluarra në mjedis të Projektit bashkë me zhvillime të tjera ekzistuese ose të planifikuara në zonë? (duhet të përshkruhen skenarë të ndryshëm të së ardhmes përfshirë një skenar të rastit			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	më të keq).			
4.21	A janë përshkruar efektet e përkohshme, afatshkurtra të shkaktuara gjatë ndërtimit apo gjatë fazave të operimit dhe çinstalimit / mbylljes së operacioneve të projektit me kohë të kufizuar?			
4.22	A janë përshkruar efektet afatmesme të shkaktuara gjatë ndërtimit apo gjatë fazave të operimit dhe çinstalimit / mbylljes së operacioneve të projektit me kohë të kufizuar?			
4.23	A janë përshkruar efektet afatgjata në mjedis shkaktuar gjatë kohëzgjatjes së operacioneve të projektit ose shkaktuar nga shtimi i ndotësve në mjedis?			
4.24	A janë përshkruar efektet e përhershme në mjedis shkaktuar nga ndërtimi, operimi apo çinstalimi / mbyllja e operacioneve të projektit?			
4.25	A janë përshkruar efektet që mund të rezultojnë nga aksidentet, ngjarjet anormale apo ekspozimi i projektit ndaj fatkeqësive natyrore apo atyre të shkaktuara nga njeriu dhe a janë llogaritur ato aty ku është e përshtatshme?			
4.26	A janë përshkruar efektet në mjedis shkaktuar nga aktivitete ndihmëse të projektit kryesor? (aktivitetet ndihmëse janë pjesë e projektit, por zakonisht ndodhin larg vendodhjes së projektit kryesor p.sh. ndërtimi i rrugëve të aksesit dhe infrastrukturës, lëvizjet e trafikut, gjetja e burimeve të agregatëve ose lëndëve të tjera të para, gjenerimi i energjisë dhe furnizimi me energji, asgjesimi i mbetjeve			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	ose mbetjeve të lëngshme)			
4.27	A janë identifikuar siç duhet shtrirja gjeografike, kohëzgjatja, shpeshësia, kthyeshmëria dhe probabiliteti i ngjarjes së secilit efekt?			
<i>Parashikimi i efekteve në shëndetin e njeriut dhe çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm</i>				
4.28	A janë përshkruar efektet parësore dhe dytësore në shëndetin e njeriut dhe mirëqenie dhe a janë llogaritur ato aty ku është e përshtatshme? (p.sh. efektet të shëndeti shkaktuar nga çlirimi i substancave toksike në mjedis, risqet për shëndetin që lindin nga rreziqet e mëdha të lidhura me projektin, efektet e shkaktuara nga ndryshimet në vektorët e sëmundjeve të shkaktuara nga projekti, ndryshimet në kushtet e jetesës, efektet mbi grupet e pambrojtura)			
4.29	A janë diskutuar aty ku duhet ndikimet mbi çështje si biodiversiteti, ndryshimi i klimës globale dhe zhvillimi i qëndrueshëm?			
<i>Vlerësimi i rëndësisë së efekteve</i>				
4.30	A është diskutuar kuptimi apo rëndësia e secilit efekt të parashikuar në lidhje me respektimin e numrit dhe kërkesës ligjore, rëndësisë dhe ndjeshmërisë së njerëzve, burimeve ose pritësve të tjerë të prekur?			
4.31	Në rastet kur efektet janë vlerësuar kundrejt standarteve apo kërkesave ligjore, a janë përdorur standartet e duhura lokale, kombëtare ose ndërkombëtare dhe a janë ndjekur udhëzimet përkatëse?			
4.32	A janë përshkruar si efektet pozitive ashtu edhe ato negative në mjedis?			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
4.33	A është shpjeguar qartë rëndësia e secilit efekt?			
<i>Metodat e vlerësimit të ndikimit</i>				
4.34	A janë përshkruar metodat e përdorura për të parashikuar efektet dhe a janë diskutuar arsyet për zgjedhjet e tyre, vështirësitë e hasura, pasiguritë në rezultate?			
4.35	Në rastet kur ka pasiguri rreth hollësive të sakta të projektit dhe ndikimit të tij në mjedis, a janë përshkruar parashikimet e rasteve më të këqija?			
4.36	Në rastet kur ka patur vështirësi në hartimin e të dhënave të nevojshme për të parashikuar ose vlerësuar efektet, a janë diskutuar vështirësitë e njohura dhe implikimet e tyre për rezultatet?			
4.37	A është përshkruar qartë baza për vlerësimin e kuptimit ose rëndësisë së ndikimeve?			
4.38	A janë përshkruar ndikimet në mënyrë që i gjithë lehtësimi është zbatuar, që do të thotë, a janë përshkruar ndikimet e mbetura?			
4.39	A është niveli i trajtimit të çdo efekti i përshtatshëm për rëndësinë e tij për vendim? A fokusohet diskutimi në çështjet kryesore dhe a shmanget informacioni i panevojshëm dhe që nuk ka lidhje?			
4.40	A është vënë theksi i duhur efekteve negative më të rënda të projektit dhe më pak theks i është vënë efekteve më pak të rëndësishme?			
<i>Pyetje të tjera në lidhje me Përshkrimin e Efekteve</i>				
5. Përshkrimi i lehtësimit				
5.1	A është diskutuar potenciali për lehtësimin e këtyre efekteve në rastet kur ekzistojnë efekte negative të			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	rëndësishme në ndonjë nga aspektet e mjedisit?			
5.2	A janë përshkruar qartë masat që zhvilluesi propozon të zbatojë për të lehtësuar efektet dhe a janë shpjeguar qartë efektet e tyre në madhësinë dhe rëndësinë e ndikimeve?			
5.3	A është shpjeguar, në qoftë se efekti i masave lehtësuese të madhësisë dhe rëndësisë së ndikimeve është i paqartë?			
5.4	A është e qartë nëse Zhvilluesi ka kryer një angazhim detyrues për të zbatuar lehtësimin e propozuar apo masat e lehtësimit janë vetëm sugjerime a rekomandime?			
5.5	A janë shpjeguar arsyet e Zhvilluesit për zgjedhjen e lehtësimit të propozuar?			
5.6	A janë përcaktuar qartë përgjegjësitë për zbatimin e lehtësimit përfshirë financimin?			
5.7	A janë shpjeguar qartë arsyet, në rastet kur minimizimi i efekteve negative të rëndësishme nuk është i praktikueshëm, ose kur zhvilluesi ka zgjedhur të mos propozojë ndonjë lehtësim?			
5.8	A është e dukshme që zhvilluesi ka shqyrtuar gamën e plotë të përjasjeve të mundshme për minimizimin e efekteve përfshirë masat për të reduktuar ose shmangur ndikimet nëpërmjet vendndodhjeve ose strategjive alternative, ndryshimeve dizenjoni dhe planin e projektit, ndryshime në metoda dhe procese, trajtimi "fundi i tubit" ndryshimet në planet e zbatimit dhe praktikatat e menaxhimit, masat për të riparuar ose përmirësuar ndikimet dhe masat për të kompensuar ndikimet?			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
5.9	A janë propozuar marrëveshje për të monitoruar dhe menaxhuar ndikimet e mbetura?			
5.10	A janë përshkruar efektet negative të minimizimit të propozuar?			
<i>Pyetje të tjera që kanë lidhje me Përshkrimin e Lehtësimit</i>				
6. Përmbledhja jo-teknike				
6.1	A përfshin Raporti i Thelluar i VNM një Përmbledhje Jo-Teknike?			
6.2	A jep Përmbledhja një përshkrim konçiz, por gjithpërfshirës të projektit, mjedisit të tij, efekteve të projektit në mjedis dhe minimizimit të propozuar?			
6.3	A nxjerr në pah Përmbledhja ndonjë pasiguri të rëndësishme të projektit dhe efekteve të tij në mjedis?			
6.4	A jep Përmbledhja një pamje të përgjithshme të përjasjes në vlerësim?			
6.5	A është shkruar Përmbledhja në gjuhë jo-teknike, duke shmangur termat teknike, të dhënat e hollësishme dhe diskutimet shkencore?			
6.6	A do të jetë Përmbledhja e kuptueshme për anëtarët mesatarë të publikut?			
<i>Pyetje të tjera që kanë lidhje me Përmbledhjen Jo-Teknike</i>				
7. Cilësia e prezantimit				
7.1	A është informacioni i Raportit të Thelluar të VNM i disponueshëm në një ose më shumë dokumenta të përcaktuar qartë?			
7.2	A është dokumenti(tat) i organizuar në mënyrë llogjike dhe i strukturuar qartësisht, që lexuesi të mund ta lokalizojë informacionin lehtësisht?			
7.3	A është vënë përmbajtja e lëndës në fillim të			

Nr.	Pyetja	Ka lidhje? Po/Jo	I mjaftueshëm? Po/Jo	Çfarë informacion shtesë kërkohet?
	dokumentit(ave)?			
7.4	A ka një përshkrim të qartë të procesit që është ndjekur?			
7.5	A është prezantimi gjithpërfshirës, por konçiz duke shmangur informacionin dhe të dhënat që nuk kanë lidhje?			
7.6	A përdor prezantimi në mënyrë efektive tabelat, figurat, hartat, fotografitë dhe grafikët e tjerë?			
7.7	A përdor prezantimi në mënyrë efektive anekset ose shtojcat për të paraqitur të dhëna të hollësishme jo thelbësore për të kuptuar tekstin kryesor?			
7.8	A janë të gjitha analizat dhe konkluzionet të mbështetura mjaftueshëm me të dhëna dhe evidenca?			
7.9	A janë të gjitha burimet e të dhënave të referuara në mënyrën e duhur?			
7.10	A është përdorur terminologji e qëndrueshme gjatë gjithë dokumentit(ave)?			
7.11	A lexohet si një dokument i vetëm me referenca ndërmjet seksioneve të përdorura për të ndihmuar lexuesin të lundrojë përmes dokumentit(ave)?			
7.12	A është prezantimi i informacionit i drejtë dhe aq sa është e mundur i paanshëm dhe objektiv?			
<i>Pyetje të tjera në lidhje me Cilësinë e Prezantimit</i>				